



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2023

Mars 2024

AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)

RAPORT VJETOR

JANAR – DHJETOR 2023

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), si organ i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë, paraqet Raportin vjetor të punës për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2023 në Kuvendin e Republikës së Kosovës, përkatësisht në Komisionin Parlamentar për Legjislacion, Mandate dhe Mbikëqyrje të Agjencisë kundër Korrupsionit, sikurse është përcaktuar me nenin 15 të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Raporti vjetor i Agjencisë, mbulon periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2023 dhe paraqet në mënyrë kronologjike realizimin e aktiviteteve të bazuara në planin e performancës së vitit 2023, krahasime me vitet e kaluara dhe analiza lidhur me veprimet e parandalimit të korrupsionit që ka të bëjë me zbatimin e kornizës ligjore kundër korrupsionit.

PËRMBAJTJA	
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	5
LISTA E SHKURTESAVE	6
PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI	7
KORNIZA LIGJORE	7
ORGANIZIMI I BRENDSHËM	8
BUXHETI	9
ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA).....	12
PERSONELI.....	12
PROKURIMI	12
MENAXHIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE, SHËRBIMET ELEKTRONIKE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE.....	12
TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME GJENDJEN E PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT QË KA TË BËJË ME KOMPETENCAT E AGJENCISË	14
DEKLARIMI DHE KONTROLLI I PASURISË.....	15
PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK	17
TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT	17
ZBATIMI I LEGJISLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ	18
PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA	22
DEKLARIMI, DHE KONTROLLI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK	23
DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE	24
KONTROLLI I DEKLARIMIT TË PASURISË	26
PRANIMI I DHURATAVE NË LIDHJE ME KRYERJEN E DETYRËS ZYRTARE	27
PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE.....	29
<i>Tabela me specifikat e rasteve të trajtuara nga Autoritetet Përgjegjëse gjatë vitit 2023;</i>	32
<i>Në vijim një pasqyrë e përmbledhur e veprimeve të zyrtarëve të lartë publik për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksioneve publike</i>	35
PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK DHE MONITORIMI.....	35
VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION	36
PLANET E INTEGRITETIT	37
BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET VENDORE	38
BASHKËPUNIMIN ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA	39
BASHKËPUNIMI RAJONAL	40
AKTIVITETET MEDIATIKE.....	41

AKTIVITETET E VETËDIJESIMIT TË PUBLIKUT	41
KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE.....	41
RAPORT LIDHUR ME TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM	42
RAPORTET VJETORE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, SUBJEKTET PRIVATE, SI DHE RREGULLATORËT LIDHUR ME SINJALIZIMIN, 01 JANAR -31 DHJETOR 2023	44
PUBLIKIMI I EMRIT TË ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT.....	45
MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN	46
SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË I VJETËR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK). 48	
SHTOJCA NR.3. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2022.....	50

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti vjetor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2023 përmbledh përpjekjet dhe arritjet në luftën kundër korrupsionit në të gjitha fushat e veprimtarisë së saj. Këto janë disa nga pikat kyçe të raportit:

Fokusimi në Parandalimin e Korrupsionit: Agjencia ka përqendruar punën dhe aktivitetet e saj në parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Kjo përfshin mbrojtjen e sinjalizuesve, organizimin e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave, si dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik.

Trajtimi i Kërkesave dhe Informacioneve: Agjencia ka trajtuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesa dhe informacione të adresuara nga institucionet publike, raportime anonime, si dhe kërkesa nga media dhe shoqëria civile.

Ndihma dhe Ekspertiza për Institucionet: Agjencia ka ofruar përkrahje dhe ekspertizë profesionale në hartimin e rregullave të brendshme për parandalimin e korrupsionit sipas kërkesave dhe nevojave të institucioneve publike, e atë kryesisht në lidhje me planet e integritetit dhe çështjet e etikës.

Pasqyrimi i Punës së Agjencisë: Raporti përmban një pasqyrë të përgjithshme të punës së kryer gjatë vitit 2023, duke përfshirë aktivitetet dhe programet e trajnimit për ngritjen e vetëdijes në lidhje me parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë realizimin e produkteve vizive dhe pranimin e trajtimit të mbi 11,000 regjistrave të deklarimit të pasurisë.

Reformat në Legjislacion dhe Zbatimin e Tij: Raporti përshkruan reformat në legjislacion dhe zbatimin e tyre, të cilat kanë ndikuar në forcimin e procedurave të brendshme të operimit dhe kontrollit për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë hartimin dhe aprovimin e aktet nënligjore.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: Adresimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rajonal, duke përfshirë takime, konferenca, trajnime, dhe shkëmbim informacioni me organizata dhe institucione të tjera ndërkombëtare.

Sfida dhe Prioritetet për të Ardhmen: Raporti identifikon sfidat me të cilat është përballur Agjencia gjatë vitit 2023 dhe prezanton planet dhe prioritetet për të ardhmen në luftën kundër korrupsionit.

Këto pika paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të përpjekjeve të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit gjatë vitit 2023 dhe sfidat për të ardhmen në këtë fushë.

LISTA E SHKURTESAVE

APK Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit
ARBK Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës
ARC Agjencia për Regjistrim Civil
GJK Gjykata Kushtetuese
GJTH Gjykata Themelore
IKAP Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPK Inspektorati Policor i Kosovës
KEK Korporata Energjetike e Kosovës
KGJK Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK Këshilli Prokurorial i Kosovës
KPPK Kodi i Procedurës Penale të Kosovës
KQZ Komisioni Qendror Zgjedhor
KRPP Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LDC Leadership and Development Consultancy
MAP Ministria e Administratës Publike
MASHT Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD Ministria e Drejtësisë
MDA Menagment Development Association
MFT Ministria e Financave dhe Transfereve
MFSK Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës
MMPH Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB Ministria e Punëve të Brendshme
MSH Ministria e Shëndetësisë
MTI Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
NJPMNP Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OE Operator Ekonomik
OSBE Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
OSHP Organi Shqyrtues i Prokurimit
PSRK Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH Prokuroria e Shtetit PTH Prokuroria Themelore
QKSPEZH Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim
RAI Regional Anti- Coorruption Initiative
SPV Strategjia dhe Plani i Veprimit Agjencisë kundër Korrupsionit
TI - Transparency International
UNDP - United Nations Development Program
UP - Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
ZKM Zyra e Kryeministrit

PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I AGJENCISË, KORNIZA LIGJORE DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM, BUXHETI, PERSONELI DHE PROKURIMI

KORNIZA LIGJORE

Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë i është ndryshuar mandati dhe njëkohësisht i janë zgjeruar kompetencat dhe përgjegjësitë e saj me: Monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit, Vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni si dhe Vlerësimin e akteve ligjore kundër korrupsionit, zbatimi i të cilave ka hyrë në fuqi gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit.

Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit rregullon statusin, mënyrën e organizimit si dhe kompetencat Agjencisë për Parandalimin Korrupsionit si në vijim:

- Zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve që përfshijnë: Mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve të konfliktit të interesit dhe marrjen e masave të parapara me ligjin e veçantë; Mbikëqyrjen e deklarimit të pasurive; dhe Mbikëqyrjen e pranimit të dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare dhe ndërmarrjen e masave të parapara me ligj;
- Dhënien e mendimeve lidhur me konfliktin e interesit dhe mbikëqyrjen e dhuratave që lidhen me kryerjen e detyrës zyrtare;
- Mbikëqyrjen dhe marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e sinjalizuesve.
- Ndërmarrjen e veprimeve në fushën e monitorimit të planit të veprimit të strategjisë nacionale kundër korrupsionit, vlerësimit kundër- korrupsion të akteve ligjore, vlerësimeve të rrezikut të korrupsionit dhe planeve të integritetit që përfshijnë:
- Dhënien e ndihmës profesionale dhe teknike, këshilla dhe mbështetje të iniciativave të cilat synohen të ndërmerren nga institucionet për parandalim të korrupsionit;
- Dhënien e rekomandimeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Qeverinë e Republikës së Kosovës mbi vlerësimin e projektligjeve që lidhen me parandalimin e korrupsionit kur kjo kërkohet nga këto institucione apo me vendim të Drejtorit të Agjencisë;
- Monitorimin e zbatimit të Strategjisë Kundër Korrupsionit dhe planit të saj të veprimit;
- Bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe shoqërinë civile për vetëdijësimin e publikut për parandalimin e korrupsionit;
- Zhvillimin dhe mbikëqyrjen e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe Dhënien e opinionëve lidhur me aktet ligjore për qëllim të përafrimit me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit;
- Monitorimin e zbatimit të planit të integritetit të institucioneve publike;
- Kryerjen e hetimeve administrative dhe ndërmarrjen e veprimeve në rastet që bien në kuadër të kompetencave të Agjencisë; Referimin e kallëzimeve penale në prokurorinë e shtetit ose në rast të shkeljes administrative përcjelljen e rastit tek organi administrativ kompetent
- Inicimin e procedurave kundërvajtësve nga fushë veprimtaria e vet në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi dhe Shqiptimi i gjobave dhe ndërmarrjen e masave tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, ndryshimet që kanë reflektuar në procesin e deklarimit të pasurisë, kanë të

bëjnë me zgjerimin e listës së subjekteve deklaruese, përfshirjen e kategorive të reja të cilat ligji i ka obliguar me deklarimin e pasurisë si: mjekët e licencuar që ushtrojnë veprimtari në institucionet publike (niveli dytësor dhe terciar), profesorët e Universiteteve Publike, zyrtarët doganorë etj, të cilat kategori sipas ligjit obligohen t'i nënshtrohen deklarimit të pasurisë një (1) vit nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.08/L-108. Shqiptimi i gjobave nga Agjencia ndaj subjekteve deklaruese, zyrtarëve kontaktues të institucioneve, në rast të mos përmbushjes me kohë dhe konform obligimeve ligjore për deklarimin e pasurisë është po ashtu një nga ndryshimet e Ligjit Nr. 08/L-108, si dhe deklarimi i pasurisë përmes sistemit elektronik.

Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave rregullon procesin, mënyrat dhe procedurat e deklarimit të pasurisë dhe të dhuratave, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe dhuratave, ngritjen e integritetit të zyrtarëve publikë/ subjekteve deklaruese me qëllim të parandalimit të korrupsionit, konfliktit të interesit, si dhe fuqizimin e integritetit të institucioneve publike, përfshirë edhe sanksionimin.

ORGANIZIMI I BRENDSHËM

Organizimi i brendshëm i Agjencisë gjatë vitit 2023 ka funksionuar sipas Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Rregullores Nr. 01/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr. 01/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Kundër Korrupsionit, pavarësisht faktit se me miratimin e kornizës së re ligjore Agjencia ka ndryshuar mandatin dhe përgjegjësitë e saj, duke filluar nga vet emërtimi i Agjencisë. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në vitin 2023 ka funksionuar me 41 të punësuar/zyrtarë sipas strukturës organizative Rregullores Nr. 01/2013 me plotësim/ndryshimet e saj, në departamente, divizione dhe zyra.

- Departamenti për Luftimin e Korrupsionit i cili me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ka vepruar konform ndryshimeve të reja ligjore, sipas autorizimit të Drejtorit të Agjencisë, deri në riorganizimin e Agjencisë sipas mandatis të ri ligjor, ka vazhduar me procedimin e rasteve të hetimeve paraprake, si dhe ndërmarren e veprimeve tjera në analizimin e të dhënave statistikore dhe të dhënave të tjera për gjendjen e korrupsionit në Kosovë, hartimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër Korrupsionit, mbrojtjen e sinjalizuesve sipas Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe raportimin për zbatimin e detyrave të Agjencisë të përcaktuara nga dokumentet tjera strategjike. Po ashtu, ky Departament është angazhuar në kryerjen e detyrave lidhur me mandatin e ri të Agjencisë sa i përket: Zhvillimit të Metodologjive për Monitorimin e zbatimit të planeve të integritetit, Vlerësimin e rrezikut nga korrupsioni si dhe Vlerësimin e akteve ligjore kundër korrupsionit, si dhe rolit të Agjencisë në hartimin e planeve të integriteti nga autoritetet përgjegjëse. Ky Departament është përbërë nga: 1. Divizioni për Hetime dhe Analiza, 2. Divizioni për Hetime dhe Strategji, dhe 3. Divizioni për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.
- Departamenti për Parandalimin e Korrupsionit i cili është përgjegjës për mbikëqyrjen e pasurisë, mbikëqyrjen e dhuratave dhe parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe korrupsionit në tërësi. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Deklarimin e Pasurisë dhe Dhuratave dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik.
- Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i cili është përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesit të zyrtarëve të lartë publik gjatë ushtrimit të funksionit publik, bashkëpunon me Autoritetet Përgjegjëse, merret me analizimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, pranon raportet vjetore nga Autoritetet Përgjegjëse, ofron asistencë profesionale dhe këshilla për

institucionet tjera në fushën e parandalimit të konfliktit të interesit. Ky Departament është i përbërë nga: 1. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Zyrtarë të Lartë dhe Autoritete Përgjegjëse, dhe 2. Divizioni për Parandalimin e Konfliktit të Interesit për Autoritete Përgjegjëse dhe Personat Zyrtarë.

- Departamenti për Financa dhe Punë të Përgjithshme i cili është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen për burimet materiale, ofrimin e shërbimeve administrative, menaxhimin e financave dhe buxhetit si dhe logjistikën e Agjencisë. Ky Departament është i përbërë nga Divizioni për Shërbime të Përgjithshme, Buxhet dhe Financa.
- Zyra për Mbështetje Profesionale dhe Bashkëpunim e cila është përgjegjëse në ofrimin dhe mbështetjen profesionale ligjore, menaxhimin dhe administrimin e të dhënave elektronike të Agjencisë dhe të sistemit të TI-së, ofrimin e bashkëpunimit dhe mbështetjes në çështje të ndryshme tekniko-administrative, si dhe arkivimin e shkresave zyrtare.
- Koordinator i Zyrës për Komunikim me publikun i cili është përgjegjës në organizimin, koordinimin, drejtimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me informimin e publikut dhe mediave përkitazi me punën, aktivitetet dhe veprimtarinë e Agjencisë.
- Menaxheri i personelit dhe Menaxheri Prokurimit përgjegjës për proceduat e rekrutimit, për menaxhimin e disa aktiviteteve të prokurimit. Ky organizim është ndryshuar me rastin e hyrjes në fuqi të Rregullores së re për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci.

(Shtojca 1 dhe 2. Organogrami i Agjencisë)

BUXHETI

Agjencia është institucion i pavarur dhe i specializuar për zbatimin e politikave shtetërore për parandalimin e korrupsionit në Kosovë, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Agjencinë: APK harton buxhetin vjetor në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, dhe vendosë në mënyrë të pavarur për përdorimin e buxhetit, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Buxheti i Agjencisë për vitin 2023 ka qenë në shumën prej 557,843.91€, ndërsa pas procesit të rishikimit buxheti final ka qene 656,407.18€. Mjetet e ndara janë planifikuar dhe janë menaxhuar sipas obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe kërkesat për fonde sipas kategorive ekonomike, mjetet e ndara janë adresuar në përmbushjen e nevojave reale të institucionit. Tabela në vazhdim pasqyron buxhetin fillestar të aprovuar me Ligjin për buxhetin, sipas kategorive ekonomike, buxhetin final, shpenzimet të shprehura edhe në % të realizimit.

	Kategoritë ekonomike	Buxheti i aprovuar (fillestar)	Buxheti final Pas rishikimit	Shpenzimet në total	% e realizimit bazuar në buxhetin final
Nr.		a	b	c	d=(c÷b)
1	Paga dhe Shtesa	415,287.91	513,851.18	513,851.18	100%
2	Mallra dhe Shërbime	114,056.00	114,056.00	101,110.04	88.65%
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	8,500.00	2,703.01	31.8%
4	Pasurit kapitale jo financiare	20,000.00	20,000.00	6,677.00	33.4%
5	Pranimet -Të Hyrat	-	-	-	
	Totali	557.843.91	656,407.18	624,341.23	95.1%

Alokimi i fondeve është bërë në bazë të planifikimit sipas Planit të Rrjedhës së Parasë, të përgatitur nga Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në bashkëpunim me Zyrtaren e Prokurimit dhe Drejtorin e Agjencisë. Buxheti i aprovuar sipas ligjit për buxhetin ka plotësuar nevojat e planifikuara të Agjencisë në realizimin e të gjitha obligimeve financiare. Nga buxheti final prej 656,407.18€, për të gjitha kategoritë, është shpenzuar në total shuma prej 624,341.23 €, apo shprehur në përqindje 95.1%.

Paga dhe Shtesa - Ndarjet fillestare në kategorinë e Paga dhe Shtesa kanë qenë 415,287.91 €, ndërsa buxheti final ka qenë 513,851.18, kurse janë shpenzuar 513.851.18 €, shprehur në përqindje 100%. Dallimi në mes të buxhetit fillestar dhe atij final ka ardhur si rezultat i hyrjes në fuqi të Ligjit për Pagat dhe implikimeve financiare që i ka sjell ky ligj. Agjencia ka bërë kalkulimet dhe me kohë ka njoftuar MFPT përkatësisht departamentin e Buxhetit për mungesën e mjeteve në Kategorinë e Pagave dhe Shtesave. Dallimi në mes të buxheti fillestar dhe atij final në kategorinë e Pagave dhe Shtesave ka qenë 98,563.27€.

Mallra dhe Shërbime - Buxheti i ndarë në kategorinë Mallra dhe Shërbime ka qenë 114,056.00€, këtu nuk kemi ndryshme të buxheti final nga buxheti fillestar, ndërsa janë shpenzuar 101,110.04 €, përqindja e realizimit të buxhetit është në masën 88.6%. Të gjitha shpenzimet e realizuara në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kanë mbuluar nevojat për furnizime dhe shërbime të ndryshme të Agjencisë. Agjencia i është përgjigjur kërkesës së MFPT për evidentimin e kursimeve të mundshme dhe ka deklaruar si kursime shumë prej 6,000.00€, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxheti final.

Shpenzimet Komunale - Buxheti i ndarë në kategorinë e Shpenzimeve Komunale ka qenë 8,500.00€, ndërsa janë shpenzuar 2,703.01€, shprehur në përqindje 31.8%. Te kjo kategori Agjencia ka bërë pagesën e telefonisë fikse pasi që obligimet e tjera që rrjedhin nga kjo kategori janë të mbuluara nga ana e MPB.

APK i është përgjigjur kërkesës së MFPT për evidentimin e kursimeve në kategorinë e Shërbimeve Komunale dhe ka deklaruar shumën prej 5,500.00€ si mjete të lira, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxhetin final.

Investime Kapitale - Agjencia gjatë viti 2023 ka pas të planifikuar tri projekte kapitale dhe Buxheti i ndarë në kategorinë për Investime Kapitale për vitin 2023, ka qenë 20,000.00€, ndërsa, buxheti i shpenzuar 6,677.00€, shprehur në përqindje 33,4%.

-Blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative në dhomën e serverëve - Projekt i bartur nga viti i kaluar, derisa një pjesë e tij është realizuar në vitin 2023.

-Blerja e Kompjuterëve- Laptop – mjetet e ndara për këtë projekt kanë qenë 4,000.00€, ndërsa nga ky projekt janë shpenzuar 3,992.00€.

-Krijimi dhe Dizajnimi i Ueb Faqes së APK - mjetet e ndara për këtë projekt kanë qenë 6,000.00€, ndërsa nga ky projekt janë shpenzuar 1,920.00€.

APK i është përgjigjur kërkesës së MFPT për evidentimin e kursimeve në kategorinë për Investime Kapitale dhe ka deklaruar shumën prej 9,150.00€, mirëpo kjo nuk është reflektuar në buxhetin final.

Të Hyrat - gjatë vitit 2023 nuk ka **Pranime/ Të hyra**.

Tabela në vijim pasqyron ndarjen buxhetore sipas kategorive ekonomike dhe shpenzimeve në dy vitet e fundit

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti final për vitin 2023	Shpenzimet 2023	Buxheti final për vitin 2022	Shpenzimet 2022	Buxheti final për vitin 2021	Shpenzimet 2021
		a	b	c	d	e	f
1	Paga dhe Shtesa	513,851.18	513,851.18	413,222.00	413,201.12	389,901.46	389,901.46
2	Mallra dhe Shërbime	114,056.00	101,110.04	114,056.00	112,242.13	39,617.83	39,454.66
3	Shpenzime Komunale	8,500.00	2,703.01	3,500.00	3,196.47	2,320.96	2,320.96
4	Pasurit jo financiare/kapitale	20,000.00	6,677.00	8,216.00	7,273.92	-	-
	Totali	656,407.18	624,341.23	538,994.00	535,913.64	431,840.25	431,677.08

ADRESIMI I REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA)

Me rastin e kontrollit financiar për vitin 2022, vlerësimi i përgjithshëm për pasqyrat financiare në të gjitha aspektet materiale ka pasur prezantim të drejtë dhe të vërtetë. Në Raportin e Auditimit për PVF të APK-së, nuk kemi pasur as një rekomandim, ndërsa për vitin 2023 jemi në proces të auditimit nga ZKA dhe ende nuk kemi pranuar raportin e auditimit.

PERSONELI

Agjencia ka të punësuar 43 zyrtarë, prej të cilëve 2 zyrtarë janë në pushim pa pagesë, pozita të pezulluara konform Ligjit Nr. 08/L-179 për Zyrtarët Publik. Në kuadër të planit të rekrutimit janë zhvilluar procedurat e rekrutimit dhe është zgjedhur pozita: Zyrtar i Lartë për Mbikëqyrjen e Deklarimit të Pasurisë dhe Dhuratave (me afat të caktuar). Bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e menaxhimit të burimeve njerëzore është zbatuar dhe monitoruar plani për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Agjencisë. Njësia e Personelit ka menaxhuar të gjitha sistemet që lidhen direkt me përgjegjësit e NJMBNJ-së, si sistemi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore <https://hrmis.rks-gov.net/>, sistemi i Hyrje Daljeve <http://smvp.rks-gov.net/>, sistemi i Arkivave <https://smaed-online.rks-gov.net/> dhe sistemi i Menaxhimit të Pagave.

Po ashtu, në pajtim me Rregulloren Nr. 08/2023 për Shtesën për të Punësuarit në Sektorin Publik, duke marrë për bazë Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencia ka klasifikuar pozitat sipas Rregullores nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe si rrjedhojë e kësaj është bërë edhe Rregullorja e Brendshme për Organizimin dhe Sistematizimin e vendeve të Punës.

(Shtojca nr.3, Lista e pjesëmarrjes në trajnime, forume, seminare brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2023)

PROKURIMI

Bazuar në Planin e Prokurimit për vitin 2023 nga 23 aktivitete të planifikuara të prokurimit janë realizuar 18 aktivitete, ndërsa 5 aktivitete nuk janë iniciuar ose janë anuluar për arsye të ankesave, ndërsa në kuadër të aktiviteteve të prokurimit janë iniciuar kërkesat për realizimin e aktiviteteve të prokurimit pranë AQP-së, nxjerrja e urdhër blerjeve në SIMFK dhe menaxhimi i kontratave.

MENAXHIMI I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE, SHËRBIMET ELEKTRONIKE DHE TEKNOLOGJIA INFORMATIVE

Në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, është bërë zhvillim i hovshëm në procesin e transformimit digjital të Agjencisë. Projekti i transformimit të mënyrës së deklarimit të pasurisë nga forma fizike në atë elektronike është implementuar në fund të muajit shkurt 2023. Në fillim të muajit mars 2023, për herë të

parë është lancuar për publikun platforma elektronike, Sistemi për Menaxhimin e të Dhënave të Agjencisë - DMSA (Data Management System of Agency). Në këtë kohë kemi lancuar aplikacionin për regjistrimin e subjekteve deklaruese nga zyrtarët kontaktues nëpër institucione, aplikacioni “Pikat e Kontaktit” <https://pikatekontaktit.rks-gov.net>, i cili mundëson regjistrimin/çregjistrimin e subjekteve deklaruese nëpër institucione. Në të njëjtën kohë është bërë lancimi edhe i aplikacionit të deklarimit online të pasurisë <https://e-deklarimi.rks-gov.net>, i cili iu mundëson subjekteve deklaruese të bëjnë deklarimin e pasurisë në mënyrë elektronike përmes internetit. Që të dy këto aplikacione janë pjesë përbërëse e sistemit DMSA. Implementimi dhe funksionalizimi i këtyre dy aplikacioneve ka bërë të mundur që procesi i krijimit të listave të subjekteve deklaruese të digjitalizohet plotësisht dhe të jetë dinamik, si dhe procesi i deklarimit të pasurisë të transformohet në deklarim elektronik-online. Këto dy module të sistemit DMSA, janë lidhur përmes platformës shtetërore të interoperabilitetit – GG (Government Gateway) me data bazën e Agjencisë së Regjistrimit Civil, në mënyrë që të bëjmë konsumimin e të dhënave personale (emri, emri i prindit, mbiemri, ditëlindja, gjinia vendlindja, statusi martesor, etj.) të sakta të subjekteve deklaruese përmes numrit identifikues të letërnjoftimit. Në pjesën e dytë të vitit 2023, është lancuar edhe aplikacioni për menaxhimin e rasteve DMSA-CMS, përmes të cilit është bërë transformimi digjital i përzgjedhjes së subjekteve deklaruese për kontroll të plotë të pasurisë, si dhe është digjitalizuar komplet procesi i verifikimit të deklarimeve të pasurisë.

Këtë vit përmes sistemit të deklarimit online “e-deklarimi” kemi gjeneruar mbi 10,000 regjistra të deklarimeve në formatin pdf, të cilat janë publikuar në ueb faqen zyrtare të Agjencisë <https://apk-rks.net/index.php/regjistrat/>.

Në figurën vijuese është paraqitur numri i projekteve të realizuara të teknologjisë informative, i aplikacioneve dhe i shërbimeve elektronike të Agjencisë për vitet 2021, 2022 dhe 2023.




Figura 1. Paraqitja grafike e projekteve të TI-së, aplikacioneve, dhe e-Shërbimeve për periudhën 2021-2023

Përveç implementimeve të suksesshme që janë bërë për e-shërbimet e reja të Agjencisë, të cilat janë në kuadër të sistemit elektronik DMSA, edhe përkundër stafit të limituar të TI-së, është arritur që gjatë vitit raportues të menaxhohet dhe administrohet i tërë sistemi i rrjetit kompjuterik dhe i pajisjeve përcjellëse të tij, duke përfshi serverët, routerët, switch-të, etj. Po ashtu, është mirëmbajtur dhe ka qenë në funksion

data-baza me aplikacion e deklarimeve të vjetra të Agjencisë, SDRP (sistemit i deklarimit dhe regjistrimit të pasurisë), në të cilën janë të regjistruara deklaratimet nga viti 2011 deri në vitin 2022.

Gjatë vitit raportues janë proceduar dhe janë përfunduar edhe disa projekte të tjera të TI-së, si blerja e kompjuterëve të rinj për stafin e Agjencisë, blerja e pajisjeve të tjera të TI-së, si projektor, hologram, etj., projekti i produkteve të dizajnit dhe brendimit sipas emërimit të ri të Agjencisë. Ndërsa, disa projekte janë iniciuar ose janë në procedurë, si zhvillimi i platformës elektronike për raportimin online të korrupsionit “Për Kosovës Pa Korrupsion”, ri-zhvillimi i ueb faqes së Agjencisë, e cila tani është e hostuar dhe në përdorim në linkun <https://apk-rks.net/>, projekti për të dhënat e hapura të regjistrave të deklarimit, etj.

TË DHËNA STATISTIKORE LIDHUR ME GJENDJEN E PARANDALIMIT TË KORRUPSIONIT QË KA TË BËJË ME KOMPETENCAT E AGJENCISË

Nga numri total i rasteve të pranuar në Agjenci, të paraqitura në mënyrë kronologjike në raportin vjetor të punës, statistikatat dhe analizat e rasteve të trajtuara nga Agjencia, tregojnë se krahasuar me vitet paraprake, rezultatet e punës janë të dukshme dhe kanë shënuar rritje të vazhdueshme të numrit të kërkesave dhe rasteve të adresuara për trajtim në Agjenci në fushat e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, të bazuara në kompetencat e Agjencisë për parandalimin e konfliktit të interesit, saktësisë së raportimit të pasurisë, parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik dhe rastet e sinjalizimit.

Në kuadër të procedurës administrative të hetimeve paraprake, gjatë vitit raportues, Agjencia trajtoi gjithsej 66 raste nga të cilat 59 raste janë përcjellë në Prokurori për procedim të mëtutjeshëm dhe 7 raste janë mbyllur. Në vitin 2023, janë bartur 65 raste të vitit 2022, përderisa në vitin 2022, janë bartur 152 raste të vitit 2021.


Krahasimi me vitet paraprake sa i përket numrit të rasteve të trajtuara në kuadër të procedurës së hetimeve paraprake nuk mund të bëhet, për arsye se funksioni i Agjencisë për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake, ku kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci, sipas ndryshimeve ligjore, përkatësisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është shuar dhe rastet e trajtuara në kuadër të kësaj procedure janë raste të bartura nga viti paraprak të cilat APK ka qenë e detyruar që ti procedoj sipas mandatit që e ka pasur në kohën e inicimit të rastit.

TRAJTIMI I RASTEVE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT

Agjencia, në kuadër të misionit të vet fokus të veçantë ka parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Këtë e bënë pas trajtimit të rasteve, përmes nxjerrjes së vendimeve, opinionëve, rekomandimeve, këshillimeve për institucionet, zyrtarët publik, me rastin e paraqitjes së situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2023, Agjencia trajtoi gjithsej 216 raste.

Nga numri total i rasteve, 98 raste janë trajtuar me paraqitjen e kërkesave nga personat fizik apo juridik, 54 prej tyre sipas detyrës zyrtare, 8 raste janë trajtuar nga raportimet e mediave, 2 raste nga Organizatat Jo-Qeveritare dhe 54 raste janë trajtuar nga informatat e pranuar në formë të raportimit nga jashtë.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tri vitet e fundit, shohim se në vitin 2021 kanë qenë 105 raste, në vitin 2022 kanë qenë 233 raste, kurse në vitin 2023 kanë qenë gjithsej 214 raste të paraqitura.




DEKLARIMI DHE KONTROLI I PASURISË

Karakteristikë e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë gjatë krahasimit të tre viteve rezulton rritja e përgjegjësisë së zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë brenda afateve ligjore.

Në vitin 2021 nga 4892 subjekte deklaruese, 4783 ose (97.77%) deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 109 ose 2.03% të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Viti 2022, shënoi një rritje të llogaridhënies dhe përgjegjësisë së zyrtarëve të lartë publik për ta deklaruar pasurinë brenda afateve të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, nga gjithsej 4748 subjekte deklaruese, 4687 ose (98.72%) deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 61 ose (1.28%) të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë.

Ndërsa, në vitin 2023, sipas deklarimit të rregullt vjetor kanë pasur për obligim ta deklarojnë pasurinë **4709**, nga numri i përgjithshëm nuk kanë respektuar afatin kohorë vetëm 11 subjekte deklaruese. Subjektet deklaruese që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë për herë të parë kanë qenë **3791**. Nga ky numër i përgjithshëm afatin kohor nuk e kanë respektuar 27 subjekte deklaruese.



	Të obliguar për deklaram	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2023	9631	9593	38
2022	4748	4687 (98.72%)	61 (1.28%)
2021	4892	4783 (97.77%)	109 (2.23%)

Përkushtimi për të respektuar afatin kohor të trajtimit të rasteve të trajtuara në Agjenci, duke pasur parasysh edhe çështjet teknike të zhvillimit të kontrollit përmes sistemit elektronik DSMA, kontrolli i plotë është filluar me vonesë dhe gjatë vitit 2023 ka filluar me grumbullimin e informacioneve nga institucionet relevante për të bërë verifikimin e deklarimeve të pasurisë së deklaruar në Agjenci nga subjektet deklaruese. Në vitin 2023 janë bartur për vitin 2024, 1708 raste sipas listës së kontrollit, si dhe 8 raste që kemi pranuar sipas informacionit.

(TABELA)

Rastet e bartura	Vitet
1716	2023-2024
22	2022- 2023
225	2021-2022

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIMIN PUBLIK

Me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme korruptive në prokurimin publik, Agjencia ka bërë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit publik nga kërkesat e pranuar nga institucionet publike, monitorimin e publikimit të aktiviteteve të prokurimit në ueb faqen zyrtare të KRPP-së nga autoritetet kontraktuese, aktivitetet me vlerë të vogël, të madhe dhe të mesme. Në periudhën raportuese janardhjetor 2023, Agjencia ka trajtuar 218 raste lidhur me aktivitetet e prokurimit publik, të cilat me vendim janë iniciuar nën dyshimin e arsyeshëm për shkelje ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit që kanë rezultuar me nxjerrjen e 211 opinionëve, prej të cilave 162 opinione janë respektuar nga ana e institucioneve, 49 opinione nuk janë respektuar, 33 raste janë dërguar për hetim paraprak, ndërsa 7 raste janë mbyllur.

(GRAFIKONI)

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2023

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (te respektuara)	Opinione (te parespektuara)	NE HETIM
195	109	5	87	22	1

Numri i rasteve të trajtuara për parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, gjithashtu ka tejkaluar dukshëm numrin e trajtimit të rasteve për tri vjetët e fundit nga 80 raste sa ishin trajtuar në vitin 2020 dhe 108 raste në vitin 2021, në periudhën raportues janar-dhjetor 2022 numri i trajtimit të rasteve u rrit në 100% me trajtimin e gjithsej 218 rasteve. Paralelisht me rritjen e numrit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2022, pas trajtimit të rasteve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në prokurimin publik u nxorën 211 opinione që gjithashtu tejkaluan shumëfishin e opinionëve të vitit 2021, vetëm 18 opinione, ndërsa në vitin 2020, 54 opinione.

Rastet e trajtuar në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik 2023-2022- 2021
2023 195 raste te trajtuara
2022- 218 raste të trajtuara
2021- 108 raste të trajtuara

TRAJTIMI I RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Trendi i rritjes së trajtimit të rasteve trajtimit të informative dhe raportimeve në Agjenci gjithashtu shënoi rritje edhe në paraqitjen e rasteve të sinjalizimit. Gjatë vitit 2023 janë pranuar 20 raste, krahasuar me 14 raste sa janë raportuar gjatë vitit 2022, tregon një trend të rritjes së numrit të raportimeve. Ndërsa, janë trajtuar si në vijim:

Trajtimi i rasteve të sinjalizimit 2022-2023
2023- 18 raste të trajtuara
2022 – 17 raste të trajtuara

ZBATIMI I LEGJISLACIONIT KUNDËR KORRUPSIONIT, SI DHE PLOTËSIMI DHE NDRYSHIMI I TIJ

Në zbatim të detyrimeve ligjore, sipas kornizës ligjore ekzistuese si dhe me ndryshimet e reja të saj, Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit si dhe Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave, Agjencia ka vazhduar misionin e saj drejtë zbatimit të legjislacionit si dhe ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësive të saj rreth përmbushjes së obligimeve ligjore në zbatimin, përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor, duke miratuar akte nënligjore si dhe dokumente të rëndësishme strategjike si: rregullore, metodologji, udhëzues praktik, me hyrjen në fuqi të të cilave Agjencia ka përmbush detyrimet e saj ligjore sipas kornizës së re legislative, në zbatimin e detyrave dhe funksionalizimin e kompetencave të reja sipas legjislacionit në fuqi.

Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
Ligjit Nr. 04-L-050 Për deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, me ndryshim/plotësimet e tij, deri me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri Ligjit Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave,
Ligjit Nr. 06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik; dhe
Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe aktet nënligjore;

Duke vazhduar më pas me miratimin e akteve nënligjore dhe dokumenteve strategjike si në vazhdim:

Rregullorja Nr. 01/2023 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
Rregullorja Nr. 02/2023 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit;
Rregullorja Nr. 03/2023 për Procedurën e Hetimeve Administrative;
Metodologjia për Planet e Integritetit;
Metodologjia për Vlerësim të Korrupsionit në legjislacion;
Metodologjia për Vlerësim të Rrezikut të Korrupsionit;
Udhëzues për Procedurën e Deklarimit të Pasurisë përmes Sistemit Elektronik;

Varësisht nevojave dhe kërkesave të ndryshme ligjore, janë përpiluar parashtresa të shumta juridike (vendime, kërkesa, përgjigje, kontrata, memorandume mirëkuptimi), si dhe janë ofruar po ashtu, përgjigje, opinione apo këshilla të ndryshme profesionale për të gjitha njësitë organizative brenda institucionit, në analizimin e çështjeve të ndryshme brenda mandatit të institucionit dhe aktivitete të tjera që hyjnë në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të Agjencisë.


HETIMET ADMINISTRATIVE

Gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2023, në procedurën e hetimeve paraprake, Agjencia trajtoi gjithsej 66 informata në total, ku 59 raste janë përcjellë në Prokurori për procedim të mëtutjeshëm ndërsa 7 raste janë mbyllur. Krahasimi me vitet paraprake sa i përket numrit të rasteve të trajtuara në kuadër të procedurës së hetimeve paraprake nuk mund të bëhet, për arsye se funksioni i Agjencisë për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprake, ku kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci, sipas ndryshimeve ligjore, përkatësisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-017 për

Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është shuar dhe rastet e trajtuara në kuadër të kësaj procedure janë raste të bartura nga viti paraprak të cilat APK ka qenë e detyruar që ti procedoj sipas mandatit që e ka pasur në kohën e inicimit të rastit.

Gjatë vitit 2023 është trajtuar një informatë anonime, 62 raste u iniciuan sipas detyrës zyrtare (ex-officio) dhe 3 ndryshe.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron procedimin e 66 rasteve të trajtuara gjatë vitit 2023.



Paraqitja grafike e procedimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2023

RASTET E REFERUARA NË AUTORITETET E ZBATIMIT TË LIGJIT DHE GJYQËSORE

Gjatë periudhës raportuese në institucionet kompetente (Prokurori të Shtetit dhe Zyre të kryeprokurorit të Shtetit) për procedim të mëtutjeshëm janë përcjellë 59 kallëzime penale dhe informata, për të cilat Prokuroria e Shtetit ka njoftuar se të njëjtat janë deleguar në kompetencë të prokurorive respektive. Numrin më të madh të rasteve të përcjella në Prokurori e përbëjnë veprimet e sanksionuara sipas nenit 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës “ Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”. Ndërsa në 2 raste të përcjella në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit për veprimet e dyshuara nuk është arritur që të kualifikohen se çfarë figure të veprës penale paraqesin, për shkak të tejkalimit të mundësisë dhe kompetencës hetimore të Agjencisë.

Personat e përfshirë në këto raste i përkasin pozitave të ndryshme si: Deputet, anëtar i organit të pavarur kushtetues, zëvendës ministër, kryetar komune, prokuror special, gjyqtar, këshilltar politik dhe të jashtëm të kabinetit qeveritar, kryesues dhe ish kryesueses të asambleve komunale, këshilltar të asambleve komunale, dekan, anëtar i këshillit drejtues të institucionit të pavarur drejtor i përgjithshëm dhe ud. drejtor i agjencie ekzekutive në kuadër të ministrive, anëtarë të këshillave drejtues të institucioneve

varësë në kuadër të ministrive, drejtor departamentesh në institucione të pavarura, ministri, agjenci ekzekutive apo ndërmarrje publike qendrore, drejtor drejtorie në komuna, drejtor bordesh të ndërmarrjeve publike qendrore dhe lokale, kryeshef ekzekutiv të ndërmarrjeve publike në nivel lokal, , auditor i brendshëm në nivel qendror dhe atë lokal, zyrtar auditimi të ndërmarrjeve publike qendrore, shef i financave dhe zyrtar i financave në komuna.

INFORMATA STATISTIKORE PËR SHKARKIMET NGA PUNA, HETIMET, AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprake, Agjencia gjatë periudhës raportuese janar- dhjetor 2023 ka nxjerrë edhe një

- Kërkesë për vlerësim të shkeljeve të pretenduara nëse angazhimet e të punësuarve të tyre në institucione të tjera pa kompensime mund të ndikojë në performancë të tyre.

AKTAKUZAT DHE VENDIMET NË LIDHJE ME RASTET E REFERUARA NGA AGJENCIA

Nga informacionet e pranuar gjatë vitit 2023, nga Gjykatat respektive lidhur me rastet e dyshuara për korrupsion sipas aktakuzave të ngritura nga Prokuroritë kompetente mbi bazën e kallëzimeve penale të Agjencisë, janë nxjerr 38 Aktgjykime dënuese, 2 aktgjykime liruese si dhe 7 aktvendime refuzuese (hedhje të aktakuzave). Në mënyrë tabelore këto të dhëna sipas gjykatave duken si në tabelën vijuese.

Vendimet e gjykatave përkritazi me Nenin 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë përkatësisht 430 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë

Nr.	Gjykata	Aktgjykim dënues	Aktgjykim lirues	AKTvendime
1	GJTH. Prishtinë	22	2	3
2	GJTH. Prizren	1	-	-
3	GJTH. Gjilan	11	-	1
4	GJTH. Gjakovë	2	-	-
5	GJTH. Mitrovicë	1	-	1
7	GJTH Pejë	-	-	2
8	GJTH Ferizaj	1	-	
GJITHSEJ		38	2	7

Me aktgjykime dënuese Gjykatat kanë shqiptuar kryesisht dënime me gjobë, ka raste kur janë shqiptuar edhe dënim me kusht (dënime me gjobë dhe burgim), po ashtu edhe dënim me burgim efektiv.

Dënimet me gjobë janë shqiptuar në shumë prej 150 euro deri në 1000 euro. Këto dënime është caktuar që të paguhen kryesisht pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve dhe në disa raste me këste, me mundësinë e revokimit në dënim me burg, ku 20 euro do të llogaritet me një ditë burgimi në rast se i akuzuari nuk e paguan atë dhe e njëjta nuk mund të ekzekutohet me detyrim.

Dënimet me kusht kryesisht janë shqiptuar me dënime me burgim nga 3 muaj deri në 1 vit me kohë të verifikimit deri në 2 vjet.


Ka raste kur Gjykata ka shqiptuar dënim me burgim efektiv, e të cilat me marrëveshje në mes Gjykatave dhe të dënuarve janë zëvendësuar me dënime me gjobë.

Aktgjykimet dënuese i referohen veprës penale nga neni 437 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Kosovë, përkatësisht 430 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Kosovës, ku 27 raste për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht 14 raste janë për mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë e 5 raste për mos deklarim me rastin e mbarimit/shkarkimit nga funksioni dhe 8 raste për mos deklarim me rastin e marrjes së detyrës apo funksionit si dhe 11 raste për deklarim të rremë të pasurisë apo mos paraqitje të të dhënave të kërkuara në deklaratë sipas paragrafit 2 të këtij neni, përkatësisht 2 për mos paraqitje të saktë të të hyrave vjetore, 2 për mos paraqitje të biznesit (zotërimit të aksioneve në shoqëri tregtare), 2 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së luajtshme (veturë) dhe 4 për mos paraqitje të saktë të pasurisë së paluajtshme, ndërsa 1 rast për mos paraqitje të të ardhurave personale nga paga ose pjesëmarrja në borde, komisione ose çdo veprimtari tjetër që sjell të ardhura personale dhe pasurisë së paluajtshme.

Me aktgjykim lirues, 2 raste Gjykata ka liruar nga akuza të akuzuarit për mos deklarim të pasurisë sipas paragrafit 1, (mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë dhe me rastin e marrjes së detyrës apo funksionit). Aktvendime refuzuese, Gjykatat kanë vendosur për këto raste (3 raste mos deklarim të rregullt vjetor të pasurisë, 1 rast për mos deklarim me rastin e marrjes së detyrës apo funksionit si dhe 3 raste për mos paraqitje të saktë të pasurisë së pa luajtshme.

Në 59 rastet e përcjella në Prokurori për procedim të mëtutjeshëm penal pas konstatimeve se ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të arsyeshëm për përfshirjen në veprime korruptive, janë denoncuar 57 persona.

Figura 2, pasqyron në mënyrë grafike numrin e kallëzimeve penale dhe informataave si dhe numrin e personave të përfshirë në rastet e referuara te institucionet përkatëse.



Pasqrimi i numrit të rasteve dhe numrit të personave të përcjellë te institucionet përkatëse

Karakteristikë e rasteve të hetuara që kanë të bëjnë me veprën penale Mos deklarimi ose deklarimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare - nga neni 430 i Kodit nr. 06/L-074 Penal të Kosovë, është mos deklarimi i pasurisë brenda afateve të përcaktuara kohore

sipas ligjit në fuqi (deklarimit me marrjen e detyrës, deklarimi pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni) dhe mosparaqitja e të dhënave të kërkuara si paluajtshmëria, pasuria e luajtshme në vlerë mbi tremijë (3000) Euro, zotërimi i aksioneve në shoqëri tregtare apo të hyrave vjetore.

Në periudhën raportuese, rastet për të cilat gjatë hetimeve Agjencia ka gjetur prova për vërtetimin e dyshimeve për veprime korruptive e të cilat janë përcjellë për procedim penal të mëtutjeshëm në institucionet kompetente, i takojnë viteve të ndryshme të kryerjes së tyre, duke filluar nga viti 2017-2022. Agjencia ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë me institucionet e zbatimit të ligjit. Prokuroria e Shtetit, në bazë të mandatit të saj ka vazhduar të kërkojë prova shtesë për të shkuar përtej dyshimit të arsyeshëm dhe të bazuar në lidhje me konstituimin e elementeve të veprës penale.

Dispozitat ligjore në fuqi parashohin rastet e pushimit të hetimeve dhe hedhjes poshtë të rasteve të iniciuara në fazën e hetimeve. Rastet janë hedhur poshtë nga Prokuroria në bazë të disa arsyeve, kryesisht mungesë të provimit të dyshimeve të arsyeshme apo të bazuara për kryerje të veprës penale:

1. Ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen – është vepër e rëndësisë së vogël;
2. Merret si referencë aktgjykimi lirues i Gjykatës Supreme;
5. Në veprimet e të pandehurit nuk ekzistojnë elementet qenësore të veprës penale;
6. Mungon qëllimi si element qenësor i veprës penale;
7. Vepra e kryer nuk është vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare apo propozimit, duke udhëzuar kështu Agjencinë për inicim të procedurës administrative/kundërvajtëse;
8. Vlerësohet se lënda mund të zgjidhet me Procedurë Alternative;
11. Si pasojë e vdekjes së të pandehurit;

Gjatë kësaj periudhe raportuese Agjencia pas zhvillimit të procedurave hetimore paraprahe ka mbyllur 7 raste për shkak se pas zhvillimit të procedurës së hetimeve paraprahe është konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme apo/dhe dyshim të bazuar se rasti mund të përbëjë vepër penale apo shkelje administrative.

Agjencia përmes Prokurorive Themelore ka ushtruar gjithsejtë 25 ankesa në Prokurorinë e Apelit kundër Aktvendimeve të tyre.

Funksioni i Agjencisë për zhvillimin e procedurës së hetimeve paraprahe, ku kur një person dyshon për korrupsion, ai/ajo mund të raportojë rastin e tillë në Agjenci, sipas ndryshimeve ligjore, përkatësisht me datë 05 gusht 2022 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit është shuar. Si rrjedhojë, Agjencia i ka refuzuar në mungesë të kompetencës 81 raste duke i njoftuar dhe udhëzuar raportuesit për veprime tjera.

PËRFAQËSIMI I RASTEVE NË GJYKATA

Gjatë vitit 2023, Agjencia ka përfaqësuar gjithsej në 33 raste të iniciuara në institucionet e drejtësisë. Nga njëzetë e nëntë (29) çështje penale, në njëzetë (20) prej tyre ka përfaqësuar në Gjykata dhe në nëntë (9) raste në Prokurori. Çështjet penale për të cilat Agjencia ka përfaqësuar në Gjykata dhe Prokurori kanë qenë për vepër penale: “Mos deklarimi ose deklarimit i rrejtshëm i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave ose i dobisë tjetër materiale” sipas Kodit Penal të Kosovës.

Ndërsa në katër (4) raste tjera Agjencia ka përfaqësuar si palë e paditur pranë Gjykatës kompetente për Çështje Administrative, të cilat kanë pasur për bazë konfliktin e interesit.

Nga ajo çfarë u tha si më lartë, përfaqësimi është bërë në Gjykatat dhe Prokuroritë kompetente, varësisht se në cilën fazë kanë qenë duke u zhvilluar procedurat për rastet konkrete.

DEKLARIMI, DHE KONTROLLI I PASURISË SË ZYRTARËVE TË LARTË PUBLIK

Karakteristikë e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë gjatë krahasimit të tre viteve rezulton rritja e përgjegjësisë së zyrtarëve të lartë publik për deklarimin e pasurisë brenda afateve ligjore. Në vitin 2021 nga 4892 subjekte deklaruese, 4783 ose (97.77%) deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 109 ose (2.03%) të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Viti 2022, nga 4748 subjekte deklaruese 4687 ose (98.72%) deklaruan pasurinë sipas afatit, ndërsa 61 ose (1.28%) të zyrtarëve nuk e respektuan afatin ligjor të deklarimit të pasurisë. Ndërsa, në vitin 2023 bazuar në ligjin e ri për deklarimin e pasurisë i cili ka hyrë në fuqi nga 11 shkurti është dyfishuar numri i subjekteve deklaruese që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë. Po ashtu, ky ligj ka përcaktuar që deklarimi i pasurisë të paraqitet vetëm në mënyrë elektronike. Agjencia në bashkëpunim me UNDP kanë lansuar sistemin e deklarimit elektronik të pasurisë, gjatë fazës tranzitore janë pranuar në mënyrë fizike vetëm 624 formularë (formularët e pranuar në formën fizike janë regjistruar në sistem nga zyrtarët e Agjencisë), ndërsa deklarimet tjera janë pranuar në mënyrë elektronike duke arritur një sukses të jashtëzakonshëm në implementimin e ligjit për deklarimin e pasurisë. Sipas llojit të deklarimit të rregullt vjetor kanë pasur për obligim ta deklarojnë pasurinë **4709**, nga numri i përgjithshëm nuk kanë respektuar afatin kohorë vetëm 11 subjekte deklaruese. Subjektet deklaruese që kanë pasur për obligim deklarimin e pasurisë për herë të parë kanë qenë **3791**. Nga ky numër i përgjithshëm afatin kohor nuk e kanë respektuar 27 subjekte deklaruese.

Po ashtu, Agjencia ka lejuar qasje në përmirësimin apo korrektimin e gabimeve eventuale të deklarimeve të pasurisë të paraqitura përmes sistemit elektronik sipas kërkesave nga subjektet deklaruese brenda afatit kohor prej 30 ditëve siç përcaktohet me ligj.

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë, kontrollit të plotë të pasurisë i janë nënshtruar gjithsej 1708 subjekte deklaruese dhe 27 subjekte deklaruese sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.

GRAFIKONI

	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2023	9631	9593	38 (0.39%)
2022	4748	4687 (98.72%)	61 (1.28%)
2021	4892	4783 (97.77%)	109 (2.23%)

Përkushtimi për të respektuar afatin kohor të trajtimit të rasteve të trajtuara në Agjenci, duke pasur parasysh edhe çështjet teknike të zhvillimit të kontrollit përmes sistemit elektronik DSMA, kontrollin e plotë e kemi filluar me vonesë dhe gjatë vitit 2023 kemi filluar me grumbullimin e informacioneve nga institucionet relevante për të bërë verifikimin e deklarimeve të pasurisë së deklaruar në Agjenci nga subjektet deklaruese. Në vitin 2023 janë bartur për vitin 2024, 1708 raste sipas listës së kontrollit, si dhe 8 raste që i kemi pranuar sipas informacionit.

(TABELA)

Rastet e bartura	Vitet
1716	2023-2024
22	2022- 2023
225	2021-2022
600	2020-2021

DEKLARIMI SIPAS LLOJEVE

Bazuar në obligimet ligjore të përcaktuara me ligjin nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, Agjencia ka vazhduar ta mbikëqyrë pasurinë e subjekteve deklaruese të deklaruara në Deklarimin e rregullt vjetor, Deklarimin me marrjen e detyrës dhe Deklarimit pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni.

Deklarimi i rregullt vjetor - Zyrtarët e lartë publik kanë për obligim deklarin e rregullt vjetor të pasurisë gjatë tërë kohës së punës në shërbimin publik në afatet e përcaktuara me ligj dhe janë të obliguar ta deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre në APK, nga 1 deri më 31 mars të çdo viti për vitin paraprak nga 1 janar deri më 31 dhjetor. Deklarimin e rregullt vjetor për vitin 2023 kanë qenë të obliguar ta bëjnë gjithsej **4709** zyrtar të lartë publik.

Nga numri i përgjithshëm e kanë deklaruar pasurinë **4698**, pasurinë nuk e kanë deklaruar 11 subjekte deklaruese brenda afatit kohor.

Lista e Deklarimit të rregullt vjetor sipas Institucioneve

Institucionet	Zyrtarëve e obliguar ta deklarojnë pasurinë	Kanë deklaruar	Nuk kanë deklaruar
Presidenca	20	20	0
Kuvendi	148	147	1
Qeveria	1480	1475	5
Gjykatat	430	430	0
Prokurorit	189	189	0
Institucionet e Pavarura	493	493	0

Komunat e Kosovës	1536	1531	5
Ndërmarrjet Publike	413	413	0
TOTALI	4709	4698	11

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2023, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të rregullt vjetor të pasurisë paraqitet në tabelën në vijim përfshirë krahasimet me vitin 2021 dhe vitin 2022.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2021	4892	4783 (97.77%)	109 (2.23%)
2022	4748	4687 (98.72%)	61 (1.28%)
2023	4709	4698	11 (0.23%)

Deklarimi me marrjen e detyrës së zyrtarëve të lartë publik - Zyrtarët e lartë publik të cilët fillojnë punën në shërbimin publik në mënyrë të plotë dhe reale deklarojnë pasurinë e tyre brenda afatit ligjor në periudhën prej 30 ditësh nga dita e marrjes së detyrës.

Gjatë vitit raportues deklarimin e pasurisë kanë pasur obligim të deklarojnë edhe kategoritë e reja, subjektet deklaruese që për herë të parë janë kategorizuar si subjekte deklaruese. Të obliguar për deklarimin e pasurisë kanë qenë **3791**, kanë deklaruar pasurinë brenda afatit kohorë **3764, 27** prej tyre nuk e kanë deklaruar pasurinë brenda afatit të përcaktuar ligjor (brenda afatit tre mujor). Ashtu që gjatë vitit kanë deklaruar pasurinë edhe **586** subjekteve deklaruese me marrjen e detyrës.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2023, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit të pasurisë deklarimit me marrjen e detyrës, paraqitet në tabelën në vijim, përfshirë krahasimet me vitin 2021 dhe vitin 2022.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2021	980	938 (95.71%)	42(4.29%)
2022	270	229 (84.82%)	41 (15.18%)
2023	4377	4350	(0.62%)

Deklarimi i pasurisë pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni – Me rastin e përfundimit të angazhimit në pozitën e lartë publike, zyrtarët e lartë publik janë të obliguar ta bëjnë deklarimin e pasurisë brenda afatit tredhjet (30) ditor.

Gjatë vitit raportues Agjencia ka pranuar informacione nga zyrtarët kontaktues se ushtrimin e funksionit publik e kanë përfunduar **545** subjekte deklaruese, të obliguar të deklarojnë pasurinë pas largimit nga funksioni publik.

Për periudhën raportuese janar- dhjetor 2023, gjendja e përgjithshme e procesit të deklarimit pas mbarimit të funksionit publik paraqitet në tabelën në vijim për vitin 2021, 2022 dhe vitin 2023.

Vitet	Të obliguar për deklarim	Kanë deklaruar në afat	Nuk kanë respektuar afatin
2021	1072	1046 (97.57%)	26 (2.43%)
2022	107	89 (83.18%)	18 (16.82%)
2023	545	545	0%

Në kuadër të zbatimit të ligjit dhe ndërmarrjen e veprimeve për mos respektim të obligimeve ligjore për deklarimin e rregullt të pasurisë, deklarimin me rastin e marrjes së detyrës dhe deklarimit me rastin e përfundimit të funksionit publik, në vitin 2023 Agjencia ka vazhduar me hetim të mëtutjeshëm në procedura administrative për 1716 raste.

Bazuar në të dhënat e raportuara gjatë vitit 2023, për të gjitha llojet e deklarimit të pasurisë, kanë qenë të obliguar ta bëjnë deklarimin **9631** zyrtar të lartë publik, sikurse në tabelën në vijim.

Lloji i deklarimit	Të obliguar
Deklarimi i rregullt vjetor	4709
Me marrjen e detyrës	4377
Pas mbarimit apo shkarkimit nga funksioni	545
Numri i përgjithshëm	9631

Bazuar në vendimin e Drejtorit të Agjencisë nr. 01/1961/23, të nxjerr me datë 03/11/2023, në harmoni me Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligjin Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, si dhe në kuptim të dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, komisioni i përberë prej 5 anëtarëve, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe komunikimeve të zhvilluara gjatë vitit 2023 për subjektet deklaruuese/zyrtarët kontaktues dhe institucionet përkatëse, ka rekomanduar që ndaj 25 subjekteve deklaruuese t'u shqiptohen gjopa në shumën totale prej **5,032.79 Euro**, 8 subjekteve deklaruuese ka rekomanduar shqiptimin e masës qortim publik, si dhe për 5 subjekte deklaruuese ka rekomanduar për shqiptimin e masës qortim jo publik.

KONTROLLI I DEKLARIMIT TË PASURISË

Bazuar në mandatin që ka, APK ka zhvilluar kontrollin e plotë të formularëve për deklarim të pasurisë të paraqitur nga subjektet deklaruuese.

Kontrolli i plotë - Bazuar në obligimet ligjore, Agjencia ka zhvilluar procesin e kontrollit të plotë të pasurisë për ta verifikuar saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të deklaruara në formularët e deklarimit të pasurisë për zyrtarët e lartë publikë të cilët deklarojnë pasurinë, kontrolli i pasurisë ka filluar për subjektet deklaruuese sipas ligjit për deklarimin e pasurisë, të gjitha subjektet deklaruuese sipas nenit 4 paragrafit 1.1 deri në paragrafin 1.18, ndërsa subjektet deklaruuese nga paragrafi 1.19 deri në paragrafin 1.38 ju kanë

nënshtruar kontrollit 1/3 e subjekteve deklaruese sipas përzgjedhjes me short. Subjektet deklaruese që kanë deklaruar pasurinë për herë të parë dhe janë të përcaktuar me nenin 5, i janë nënshtruar kontrollit 50 subjekte deklaruese sipas përzgjedhjes me short.

Procesi i kontrollit të plotë të pasurisë ka filluar duke bërë krahasimin e të dhënave të deklaruara ndër vite, krahasimin e të dhënave të pranuar nga institucionet tjera si: Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve, Agjencia Kadastrale e Kosovës, Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë, Thesari, Ndërmarrjet Publike, Agjencia e Regjistrimit Civil, Administrata Tatimore e Kosovës, Universitetet Publike/Private dhe të tjera.

Nga numri i përgjithshëm i zyrtarëve të lartë publik që kanë për obligim deklarimin e pasurisë, kontrolli i plotë i pasurisë është realizuar për gjithsejtë 1708 subjekte deklaruese, sipas obligimit ligjor që ka përcaktuar kontrollin e plotë, ndërsa përveç listës së kontrollit të plotë të pasurisë, Agjencia ka iniciuar për trajtim ex-officio edhe 27 raste për zyrtar të lartë publik, apo sipas informatave të raportuara nga qytetarët përmes formave të ndryshme.

Tabela e mëposhtme pasqyron procesin e kontrollit të plotë.

Kontrolli i plotë i deklarimit të pasurisë si dhe rezultatet e gjetjeve nga kontrolli i plotë

Sipas obligimit ligjor	ex –officio (anonime)	Gjithsejtë në kontroll	Të përfunduara	Në procedurë	Të përcjella për hetim në procedura Administrative (APK) / Prokurori/Polici	
					Mos deklarim të pasurisë	Dyshimet për deklarim të rremë
1708	27	1735	19	1716	38	4

Procedura e realizimit të kontrollit të plotë të pasurisë për tri vitet e fundit:

Vitet	Kontrolli i plotë	Rastet mbyllura	Rastet proceduara për procedurë administrative	Raste të bartura në vitin 2024	Rastet (officio) e trajtuara sipas informatave anonime apo OJQ
2021	966	916 Përshkrimi me përqindje% (94.82%)	50 Përshkrimi me përqindje% (5.18%)	225 Përshkrimi me përqindje% (23.29%)	12
2022	973	916 % (94.14%)	57 % (5.86%)	13 (1.34%)	41
2023	1735	19 (1.09%)	0	1716(98.90%)	27

PRANIMI I DHURATAVE NË LIDHJE ME KRYERJEN E DETYRËS ZYRTARE

Bazuar në Ligjin nr. 08/L-108, Institucionet publike duhet t'i emërojnë zyrtarët përgjegjës për mbajtjen e regjistrit të dhuratave. Të gjitha dhuratat e pranuar dhe vlera e tyre përkatëse, si dhe emrat e personave që kanë dhënë dhuratën, duhet të regjistrohen në regjistrin e dhuratave nga personi zyrtar që përcaktohet nga Agjencia dhe që mbahen nga institucioni, në të cilin personi zyrtar ushtron detyrën. Kopjet e katalogëve duhet t'i dërgojnë në APK jo më vonë se më 31 mars të vitit në vijim.

Dorëzimi i katalogut të dhuratave

Agjencia, gjatë muajit mars të vitit 2023 ka pranuar njoftimin nga 179 institucione, prej tyre kanë deklaruar se kanë pranuar dhurata 14 institucione, ndërsa 165 kanë deklaruar se nuk kanë pranuar dhurata gjatë vitit paraprak.

Institucionet të cilat kanë dorëzuar kopjet e katalogut të dhuratave gjatë këtij viti për vitin paraprak janë: Presidenca e Republikës së Kosovës; Kuvendi i Kosovës; Zyra e Kryeministrit; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Universiteti i Prizrenit; Ministria e Ekonomisë; Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Zyra Kombëtare e Auditimit; Gjykata Kushtetuese e Kosovës; Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit dhe Akademia e Drejtësisë.

Të dhënat e specifikuar lidhur me katalogët e dhuratave sipas institucioneve që i kanë dorëzuar kopjet e katalogut në APK, janë të paraqitura në tabelën në vijim:

Nr.	Institucioni	Protokollare	Rastit	Numri i përgjithshëm
1.	Presidenca e Republikës së Kosovës	67	-	67
2.	Kuvendi i Kosovës	15	2	17
3.	Zyra e Kryeministrit	67	92	159
4.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	1	-	1
5.	Universiteti i Prizrenit	5	2	7
6.	Ministria e Drejtësisë	-	2	2
7.	Ministria e Ekonomisë	1	1	2
8.	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	-	2	2
9.	Ministria e Punëve të Brendshme	1	-	1
10.	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	1	-	1
11.	Zyra Kombëtare e Auditimit	2	3	5
12.	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	14	-	14
13.	Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit	7	-	7

14.	Akademia e Drejtësisë	0	1	1
	Gjithsej	181	105	286

Lista e katalogëve e dhuratave të deklaruara gjatë tri viteve të fundit:

Vitet	Protokollare	Rastit	Gjithsej
2021	6	22	28
2022	114	73	187
2023	181	105	286

Gjatë vitit raportues gjegjësisht nga data 04-08.09.2023, divizioni për mbikëqyrjen e pasurisë dhe dhuratave ka vizituar dhe inspektuar 13 institucione lidhur me mbajtjen dhe regjistrimin e dhuratave të deklaruara nga personat zyrtar të këtyre institucioneve. Po ashtu, janë njoftuar edhe për obligimin ligjor për ruajtjen dhe evidentimin e dhuratave dhe ekspozimin e tyre në një kënd të veçantë në institucionin e tyre përkatës.

Lista e institucioneve që janë inspektuar gjatë vitit 2023 janë:

1. Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A;
2. Posta e Kosovës Sh.A;
3. KOSTT Sh.A;
4. Hidromarava Sh.A;
5. Hidroregjioni Jugor Sh.A;
6. Ambienti Sh.A - Pejë;
7. KRU Mitrovica Sh.A, Mitrovicë;
8. Kompania Rajonale e Ujësjellësit Bifurkacion-Ferizaj;
9. Ndërmarrja Publike Lokale Ambienti Sh.A, Ferizaj;
10. Komuna Mitrovicë e Veriut;
11. Komuna Pejë;
12. Universiteti i Prizrenit – “Ukshin Hoti”, Prizren;
13. Universiteti “Kadri Zeka”, Gjilan.

PARANDALIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE

Agjencia ka ndërmarrë veprimet e duhura hetimore administrative për trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit nëpërmjet nxjerrjes së vendimeve, opinioneve, këshillave dhe rekomandimeve, gjithnjë në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Qëllimin e vet primar – parandalimin e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksioneve publike, në institucione publike të vendit, Agjencia e ka realizuar bashkërisht edhe me Autoritetet përgjegjëse nëpër institucionet publike dhe në funksion të kësaj vazhdimisht ka ofruar mbështetje profesionale për to, për t'i përgatitur ato sa më mirë në identifikimin, trajtimin dhe zgjidhjen e rasteve të paraqitjes së situatave të mundshme të konfliktit të interesit brenda institucioneve të tyre respektive.

Veprimet e Agjencisë, edhe për vitin që po raportojmë janë ndërmarrë në mënyrë objektive, të paanshme dhe profesionale e në zbatim të legjislacionit relevant në fuqi. Kjo zakonisht bëhet përmes inicimit të rasteve sipas detyrës zyrtare, informacioneve të pranuar nga personat fizik apo juridik, informatat e pranuar në formë anonime dhe informatave nga publiku, me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit në institucionet publike dhe në shërbim të forcimit të integritetit dhe transparencës institucionale në Republikën e Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2023, në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit të pretenduar, janë paraqitur gjithsej 216 raste. Nga numri total i rasteve, 98 raste janë trajtuar me paraqitjen e kërkesave nga personat fizik apo juridik, 54 prej tyre janë trajtuar sipas detyrës zyrtare, 8 raste janë trajtuar nga raportimet e mediave, 2 raste nga Organizatat joqeveritare, dhe 54 raste janë trajtuar nga informatat e pranuar në formë raportimi nga jashtë.

Krahasuar me vitet paraprake, përkatësisht me tre vitet e fundit, në periudhën raportuese janar - dhjetor 2023, është rritur numri i trajtimit të rasteve në Agjenci për parandalimin e konfliktit të interesit e sidomos në aspektin e dhënies së përgjigjeve për situata të caktuara që lidheshin me dyshime për papajtueshmëri ose ushtrim të funksionit në kushte të konfliktit të interesit.

Nëse shikojmë numrin e rasteve të paraqitura në vitet paraprake shohim se në vitin 2021 kanë qenë 105 raste, pastaj në vitin 2022 kanë qenë 233 raste, kurse tani në vitin 2023, janë gjithsej 214 raste të paraqitura.

Vlen të theksohet se përveç raportimeve dhe kërkesave të sipërpërmendura për trajtimin e pretendimeve për konflikt të interesit, në Agjenci janë adresuar disa raste për vlerësim përfundimtar të konfliktit të interesit edhe nga institucione ligj-zbatuese, siç është Prokuroria e Shtetit dhe Policia e Kosovës.

Tabela në vijim paraqet në mënyrë grafike rastet e trajtuara gjatë vitit 2023;

Institucioni	Rastet e paraqitura për K. interesi	Raste që janë shmangur nga K. Interesit	Raste pa K. Interesi	Raste për Gjykatë	Raste për Prokurori	Raste në procedurë (të bartura në 2024)	Opinione-Përgjigje
Qeveria, Agjencitë, Uni. Publike	87	5	20	1	2	5	54
Gjykata	5		1				3
Prokuroria	3						3
Institucionet e Pavarura	29	1	7			3	23
Ndërmarrje Publike	15	2	4				6
Pushteti Lokal	75	38	8	2		15	13
Gjithsejtë:	216	46	40	3	2	23	102

Për dallim nga viti paraprak, kur gjithsejtë kanë qenë të paraqitura 233 raste, për vitin që po raportojmë numri i rasteve të paraqitura është 216 që do të thotë për 19 raste me pak se vitin paraprak. Kjo vjen edhe si rezultat i fuqizimit të autoriteteve përgjegjëse nëpër institucione, që në fakt është edhe qëllim prioritet i Agjencisë, pasi që në vitin 2023 Autoritetet përgjegjëse kanë trajtuar 181 raste, e që janë 16 raste me shumë se vitin paraprak.

E gjithë kjo tregon për efikasitetin, organizimin e mirë dhe punën ekipore në kuadër të dy divizione përgjegjëse për trajtim e rasteve brenda Departamentit, përkundër mungesës së theksuar të stafit të nevojshëm në Departamentin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Numri total i rasteve të trajtuara nga Agjencia gjatë vitit 2023 rezulton si në vijim: u ofruan 102 këshilla dhe opinione, në 46 raste subjektet e trajtuara iu shmangën konflikt të interesit, 40 raste rezultuan pa konflikt të interesit, 2 raste u dërguan në Prokurori, ndërsa 3 të tjera në Gjykatën kompetente për kundërvajtje.

Nga numri 193 i rasteve të trajtuara, 54 prej tyre u iniciuan në mënyrë “sipas detyrës zyrtare” (*ex-officio*), tetë raste u trajtuan nga raportimet e adresuara nga mediat, dhe dy raste të tjera u adresuan nga Organizatat Jo-Qeveritare.

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ka përcaktuar Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit - autoritet qendror për trajtimin dhe parandalimin e konfliktit të interesit.

Përveç kësaj, neni 20 i LPKI- së ka përcaktuar se konflikti i interesit duhet të trajtohet edhe nga ana e autoriteteve përgjegjëse të institucioneve publike, duke përfshirë udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve sipas hierarkisë brenda një institucioni, si dhe ka obliguar institucionet që në kuadër të akteve të tyre të brendshme të parashohin dhe zbatojnë rregulla të veçanta për parandalimin e konfliktit të interesit, varësisht fushëveprimit të institucioneve publike.

Viti 2023 u karakterizua më rritje të numrit të trajtimit të rasteve nga Autoritetet përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit. Për dallim nga vitit 2020 ku nga Autoritetet përgjegjëse u trajtuan vetëm 46 raste, në vitin 2021 u trajtuan 101 raste, në vitin 2022 nga autoritetet përgjegjëse u trajtuan 121 raste, në vitin që po raportojmë (2023) Autoritetet përgjegjëse kanë trajtuar gjithsej 181 raste.

Institucioni	Gjithsejtë raste të paraqitura për konflikt të interesit në AP	Raste që janë shmangur nga Konflikti i Interesit	Raste pa Konflikt Interesi	Raste me Konflikt Interesi/ Dërguar në Procedurë Disiplinore	Opinion / Rekomandim	Raste ende në procedurë	Rastet e Dërguara në APK
Qeveria, Ministritë, Agjencitë Ekzekutive dhe Institucionet vartëse	86	21	16	7	25	3	14
Presidenca	1	1	-	-	-	-	-
Kuvendi i Kosovës	3	3	-	-	-	-	-
Gjykata /Prokuroria	2	-	2	-	-	-	-
Institucionet e pavarura	32	17	11	-	2	-	2
Ndërmarrje Publike	41	8	4	29	-	-	-
Pushteti Lokal	16	14	1	-	-	1	-
Gjithsejtë:	181	64	34	36	27	4	16

Tabela me specifikat e rasteve të trajtuara nga Autoritetet Përgjegjëse gjatë vitit 2023;

Në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit, gjatë vitit 2023, Agjencia ka ofruar 77 përgjigje (këshilla, rekomandime dhe sqarime), përmes komunikimit elektronik (email zyrtar), për zyrtarët publik dhe institucionet publike sipas kërkesave të tyre.

Aktivitetet në funksion të forcimit dhe fuqizimit të Autoriteteve përgjegjëse

Departamenti për Parandalimin e Konflikt të Interesit në kuadër të aktiviteteve për forcimin dhe fuqizimin e Autoriteteve përgjegjëse, gjatë vitit 2023 ka mbajtur pesë seanca të trajnimeve me përfaqësues të institucioneve publike të vendit, në cilësi të autoriteteve të emëruara për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit.

Janë mbajtur trajnime me temën: “Rëndësia e parandalimit të konfliktit të interesit, roli i autoriteteve përgjegjëse sipas legjislacionit kosovar, praktikat rajonale dhe ndërkombëtare”.

Tre nga këto trajnime kanë qenë të mbështetura nga Projekti PECK III i Këshillit të Evropës, në të cilat pos zyrtarëve të Agjencisë kanë ligjëruar edhe ekspertët rajonal dhe ndërkombëtar. Trajnimet janë mbajtur me datat; 20, 21 dhe 22 shtator 2023.



Ndërsa, dy seanca tjera të trajnimeve po me këtë temë, janë mbështetur nga OSCE dhe në to për autoritetet përgjegjëse, përfaqësues të institucioneve publike të vendit, kanë ligjëruar Drejtori i Departamentit për PKI dhe Shefi i divizionit për bashkëpunim me autoritet përgjegjëse. Trajnimet janë mbajtur me 22 dhe 23 nëntor 2023.



ANALIZA:

Numri i kërkesave për trajtimin e konfliktit të interesit, përkatësisht papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike u rrit dukshëm edhe për faktin se gjatë vitit raportues ka pas lëvizje me zgjedhje dhe emërimet të shumta në pozita drejtuese në institucionet dhe ndërmarrjet publike të vendit.

Numri i rritjes së rasteve për parandalimin e konfliktit të interesit, në njërin anë tregon besimin në ngritje të vazhdueshme dhe gatishmërinë e qytetarëve dhe zyrtarëve publik për të adresuar çështjet e konfliktit të interesit në Agjenci, si institucion i specializuar për trajtimin e kësaj problematike. Ndërsa, nga ana tjetër shpërfaqë edhe hezitimin që zyrtarët publik apo udhëheqësit e tyre të drejtpërdrejtë të vlerësojnë vet ashtu siç e kanë obligim ligjor për të zgjidhur brenda institucioneve të tyre këto situata, përkundër trajtimeve dhe këshillimeve të vazhdueshme që i bënë Agjencia për autoritetet përgjegjëse.

Duhet theksuar këtu se një numër i konsiderueshëm i kërkesave në Agjenci përcillen edhe përmes Policisë së Kosovës për trajtim të konfliktit të interesit për rastet që janë raportuar dhe iniciuar direkt nga Prokuroritë e ndryshme dhe nga vet Policia.

Ndërsa, sa i takon natyrës dhe karakteristikave të vendimeve që Agjencia i ka nxjerrë gjatë vitit 2023, duhet theksuar se ka pas vendime të natyrave të ndryshme, por gjithnjë me qëllim të shmangies së vendimmarrjeve me konflikt interesi apo papajtueshmërive në ushtrimin e funksioneve publike.

Shembuj.:

- Përmes vendimit të Agjencisë është anuluar kontrata për shërbime të veçanta e një ish- zv. Ministër i Ministrisë në kundërshtim me kufizimet (ex-post) të nenit 18 të LPKI-së;
- Është anuluar një kontratë e lidhur nën kushte të konfliktit të interesit në mes të një Ministri të një Ministrie dhe një Kolegji Privat;
- Me vendim të Agjencisë, është konstatuar konflikti i interesit lidhur me një kryetar komune, me ç'rast është anuluar vendimi i nxjerr në konflikt interesi, është kërkuar kthimi i mjeteve, dhe rasti është raportuar në prokurorinë kompetente.
- Pas vendimit të Agjencisë për konstatimin e konflikti të interesit, një drejtori të drejtorisë komunale, i është anuluar kontrata për shërbim dhe i njëjti është detyruar që t'i kthejë mjetet e përfituara përmes kontratës së prokurimit, të lidhur në kushte të konfliktit interesi, e rasti është proceduar edhe në gjykatë kundërvajtëse;
- Pas vendimit të Agjencisë për konstatimin e konflikti të interesit është anuluar akti administrativ lidhur me punësimin në kushte të vendimmarrjes me konflikti interesi, në një Spital Rajonal, e rasti është proceduar edhe në Gjykatë kundërvajtëse;

- Pas vendimit të Agjencisë për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik, për një Drejtor të drejtorisë komunale, duke qenë edhe Kryetar në Organizatë jo qeveritare, nga Agjencia është iniciuar kërkesa për fillimin e procedurës së shkarkimit dhe rasti është proceduar gjithashtu në Gjykatë kundërvajtëse.

Në vijim një pasqyrë e përmblodhur e veprimeve të zyrtarëve të larte publik për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksioneve publike

- 29 dorëheqje nga funksioni menaxhues/drejtuës dhe/ose person i autorizuar në biznese private,
- 12 dorëheqje nga Organizata Jo Qeveritare,
- 2 dorëheqje nga funksionet publike, për të mbajtur funksionet menaxhuese në bizneset private,
- 1 dorëheqje nga një funksion publik për shkak të papajtueshmërisë me një funksion tjetër publik,
- 1 rast është iniciuar me kallëzim penal.

PARANDALIMI I KORRUPSIONIT NË PROKURIM PUBLIK DHE MONITORIMI

Me qëllim të parandalimit të shkeljeve të mundshme të konfliktit të interesit dhe parregullsive të tjera të mundshme në aktivitete të prokurimit publik me elemente korruptive, Agjencia ka bërë monitorimin e aktiviteteve të prokurimit të publikuara në ueb faqen zyrtare të KRPP-së nga autoritetet kontraktuese, aktiviteteve me vlerë të vogël, të mëdhe dhe të mesme. Në periudhën raportuese janar- dhjetor 2023, Agjencia ka trajtuar 195 raste lidhur me aktivitetet e prokurimit publik, të cilat me vendim janë iniciuar nën dyshimin e arsyeshëm për shkelje ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit që kanë rezultuar me nxjerr 109 opinione, prej të cilave 87 opinione janë respektuar nga ana e institucioneve, 22 opinione nuk janë respektuar, 1 rast është dërguar në organet kompetente për hetim, 2 përgjigje lidhur me trajtimin e konfliktit të interesit në prokurimin publik, 1 vendim lidhur me trajtimin e konfliktit të interesit, ndërsa 5 raste janë mbyllur, si dhe 78 këshilla me telefon.

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2023

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (të respektuara)	Opinione (të parespektuara)	Këshilla me tel	Përgjigje K.I	Vendim për K.I	Në hetim
195	109	5	87	22	78	1	1	1

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2022

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (të respektuara)	Opinione (të parespektuara)	Në hetim
218	211	7	162	49	33

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2021

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (të respektuara)	Opinione (të parespektuara)	Këshilla me telefon (të respektuar)	Këshilla me telefon (të pa respektuara)
108	18	7	18	0	64	19

Numri i rasteve të trajtuara në fushën e parandalimit të korrupsionit në prokurimin publik – 2020

Numri i rasteve	Opinione	Raste të mbyllura me raport	Opinione (të respektuara)	Opinione (të parespektuara)	Në procedurë	Në hetim
80	54	21	51	3	4	1

VLERËSIMI I RREZIKUT DHE I AKTEVE LIGJORE KUNDËR KORRUPSION

Konform obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë në Parandalimin e Korrupsionit, sa i përket kompetencave të reja shtesë, Vlerësimi të rrezikut nga korrupsioni dhe Vlerësimi të akteve ligjore kundër korrupsionit, Agjencia ka ndërmarrë veprimet përgatitore për zbatimin e përgjegjësive ligjore në lidhje me vlerësimin e rrezikut si dhe vlerësimin kundër- korrupsion të akteve ligjore.

Në kuadër të përgjegjësive, Agjencia ka vazhduar të bëjë një analizë krahasuese të legjislacionit aktual dhe akteve nënligjore mbi nevojën për të prezantuar një vlerësim të rrezikut të korrupsionit, dhe krijimin e parakushteve për eliminimin e rreziqeve të mëtejshme. Në kuadër të zbatimit të këtij veprimi, Agjencia ka planifikuar që në strukturën e re organizative të Agjencisë që pritet të funksionalizohet në vitin 2024, të sigurojë që kjo përgjegjësi ligjore të zbatohet nga një njësi e specializuar e Agjencisë.

Përgatitja e metodologjisë së Vlerësimi të Korrupsionit, përveç legjislacionit vendor, ka marrë në konsideratë edhe rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Kosovën, autoriteteve legjislative dhe ekzekutive, në nivel shtetëror dhe lokal, detyrimet ligjore me qëllim ngritjen e nivelit të ndërgjegjësimit lidhur me përmbushjen e obligimeve të përcaktuara për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Kjo metodologji është aprovuar me vendim të Drejtorit. Kjo metodologji është aprovuar me akt nënligjor të miratuar nga Drejtori i Agjencisë.

Në vitin 2023, Agjencia në bashkëpunim me Këshillin e Evropës përmes projektit PECK 3, ka filluar përgatitjet për zhvillimin e ushtrimit mbi hartëzimin e rrezikut të korrupsionit në institucionet e sektorit publik dhe ndërmarrjet publike sipas Metodologjisë së përgatitur nga Divizioni për Bashkëpunim kundër Krimin Ekonomik i Këshillit të Evropës. Hartëzimi i rreziqeve të korrupsionit është hap i nevojshëm për të parandaluar korrupsionin dhe forcuar integritetin dhe transparencën institucionale në Kosovë. Konsiston në identifikimin e sektorëve, aktivitetëve, funksioneve me rrezik të mundshëm më të lartë të korrupsionit, që do të përdoret për të identifikuar se cilat janë fushat e rrezikut për të qenë në gjendje të vendosen prioritete për një përdorim më efikas të përpjekjeve dhe burimeve për parandalimin e korrupsionit në shërbimin publik në Kosovë. Në kuadër të këtij ushtrimi janë identifikuar institucionet të cilat përfshihen në proces dhe është përgatitë kërkesa/pyetësori për grumbullimin e informacionit dhe dokumentacionit. Procesi vazhdon në vitin 2024.

Metodologjia për vlerësim të potencialit të korrupsionit në legjislacion është aprovuar me akt nënligjor të miratuar nga Drejtori i Agjencisë dhe është e orientuar në eliminimin e rrezikut të korrupsionit dhe shkallën e përputhshmërisë së legjislacionit vendas me standardet ndërkombëtare, dhe analizën e akteve ligjore dhe nën-ligjore të institucioneve publike për eliminimin e fushave të rrezikut dhe zbrazëtirave ligjore të cilat mund të përdoren për keqpërdorim të mundshëm të detyrës zyrtare.

Agjencia sipas kësaj metodologjie ka përgatitur një draft opinion mbi dispozitat e caktuara të një ligji, i cili opinion është bartur në vitin 2024 për shqyrtim të mëtutjeshëm.

PLANET E INTEGRITETIT

Obligimi për miratimin e planeve të integritetit nga Institucionet Publike, u fuqizua, përmes miratimit të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare, 21 korrik, 2022).

Neni 25 i Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, obligon institucionet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura, dhe autoritetet komunale që të hartojnë dhe aprovjnë Planet e Integritetit, jo më vonë se gjashtë muaj nga aprovimi i metodologjisë uniforme për hartimin e këtyre planeve.

Më datë 26 korrik 2023, është miratuar Metodologjia për Planet e Integritetit nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (të cilën e gjeni në këtë link:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=78702>), e cila shërben si udhërrëfyes për të gjitha fazat të cilat duhet të ndiqen nga Institucionet, gjatë hartimit të Planit të Integritetit.

Institucionet e lartcekura kanë qenë të detyruara që në një afat prej gjashtë (6) muajsh ti kenë të miratuara Planet për Integritet.

Gjatë kësaj periudhe, APK është angazhuar fillimisht duke listuar të gjitha Institucionet përgjegjëse për hartimin e planeve të integritetit.

Pas kësaj, APK ka komunikuar përmes emailit me të gjithë drejtuesit e këtyre Institucioneve duke ju kumtuar obligimet ligjore për ndjekjen e procedurave rreth hartimit të Planeve të Integritetit dhe caktimin e zyrtarëve përgjegjës.

Pas pranimit të të dhënave rreth zyrtarëve përgjegjës, APK me përkrahjen e OSCE- Misionit në Kosovë, gjatë muajit tetor 2023, ka organizuar pesë (5) sesione të trajnimeve informuese për mënyrën e hartimit të planeve të integritetit, duke i ftuar të gjithë zyrtaret përgjegjës të caktuar nga Institucionet publike. Trajnimet janë mbajtur në datat 11, 12, 17, 19 dhe 24 tetor 2023.

Me të gjithë zyrtaret përgjegjës të caktuar nga Institucionet publike janë ndarë materialet relevante lidhur me hartimin e Planeve të Integritetit si dhe vazhdimisht është komunikuar me të njëjtit për çdo paqartësi që është shfaqur gjatë këtij rrugëtimi.

Përveç komunikimeve të vazhdueshme, janë ofruar rekomandimet për draft planet e integritetit për çdo Institucion publik që ka kërkuar një gjë të tillë dhe për më tepër janë vizituar shumë Institucione që kanë pasur vështirësi rreth hartimit të Planit të Integritetit më qëllim që kjo procedurë të shkojë mirë dhe

brenda afateve të parapara ligjore. Në vazhdimësi ju është rikujtuar afati i fundit ligjor për miratimin e Planeve të Integritetit.

BASHKËPUNIMIN ME INSTITUCIONET VENDORE

Në kuadër të bashkëpunimit me institucionet vendore, në përmbushje të obligimeve ligjore, gjatë periudhës raportuese, Agjencia ka bashkëpunuar me të gjitha institucionet relevante në kuadër të zbatimit të fushë veprimtarisë së saj janë zhvilluar një varg takime, pjesëmarrje ne plotësimin dhe hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe veprime të tjera, përkitazi me kërkesat dhe nevojat e Agjencisë. Aktivitetet dhe përfaqësimet në iniciativat e bashkëpunimit dhe koordinimit të aktiviteteve me institucionet vendore të nivelit të lartë janë zhvilluar nga Drejtori i Agjencisë si në vijim:

- Takim me zyrtare te Institutit te Kosovës për Drejtësi. /11 janar 2023
- Ttakim me zyrtare te Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /18 Janar 2023;
- Takim me Takim me Ministrin e Ministrise se Administrimit të Pushtetit Lokal -se z. Elbert Krasniqi/25 Janar 2023
- Marrë pjese ne Konferencën vjetore PAR progresi Kosovë 2023 /21 shkurt 2023
- Marrë pjese ne Konferencën Vjetore 'Rritja e Mbikëqyrjes Publike dhe Llogaridhënies Institucionale Kosovë' /22 shkurt 2023
- Drejtori i Agjencisë ka merre pjese ne Takimi i Komitetit Drejtues të Strategjisë për Sundimin e Ligjit/4 Prill 2023
- Drejtori i Agjencisë ka marre pjese ne Konferenca “Strategjia e e-Qeverisjes në funksion të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve publike” 6 prill 2023
- Drejtori i Agjencisë ka marre pjese ne takimin e parë i grupit punues përgjegjës për hartimin e Strategjisë Shtetërore kundër Korrupsionit. /23 maj 2023
- Drejtori i Agjencise ka Pritur z. Constantine Palicarsky nga UNODC / 23 Maj 2023
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në tryezën e diskutimit organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krim UNODC /26 Maj 2023
- Drejtori i Agjencisë ka takuar kryetarin e komunës së Shtimes, z. Qemajl Aliu, 21 qershor 2023
- Drejtori i Agjencisë ka marrë pjesë në Mbledhja V e Këshillit Ministror për Integrim Evropian/12 korrik 2023,
- Drejtori i Agjencisë marrë pjesë në panelin e tryezës së organizuar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI) në Kosovë, për të shqyrtuar dobësitë potenciale të Kosovës ndaj ndikimit malinj të huaj dhe kleptokracisë/ 18 korrik 2023
- Drejtori i Agjencise ka marre pjese ne takimin e përbashkët per nënshkrimin e Udhëzuesit për mënyrën e kryerjes së hetimit administrativ/18 korrik 2023
- Drejtori i Agjencise ka marre pjese në Punëtorinë Rajonale për Strategjinë Kundër Korrupsionit /1 shtator 2023
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit Yll Buleshkaj priti në takim drejtoreshën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Malin e Zi, znj. Jelena Perović / 4 shtator 2023
- Drejtori i Agjencise priti ne takim z.Nuno Queiros përfaqësuesin e Përhershëm i UNDP-së në Kosovë /25 shtator 2023
- Drejtori i Agjencise mori pjese në Konferencën mbi Transparencën e Qeverisjes Lokale të organizuar nga OJQ AKTIV /27 shtator 2023

- Drejtori i Agjencise mori pjesë në Konferencën e organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi “Java e Qasjes në Dokumente Publike”/ 28 shtator 2023
- Drejtori i Agjencise mori pjese ne takimin për grupin e punës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve në Kuvend/29 nentor 2023
- Drejtori i Agjencise mori pjese ne Konferencë e organizuar nga KDI, A ka ardhur koha për Ligjin për Lobim? /5 dhjetor 2023
- Drejtori i Agjencise mori pjese ne Konferencen “Nga transparenca te besimi: Zgjidhjet për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar në nivel institucional” CorrWatch/11 dhjetor 2023
- Drejtori Yll Buleshkaj pati takim me Ambasadorin Tomáš Szunyog, Shef i Zyrës së BE-së në Kosovë/Përfaqësues Special i BE-së, 21 dhjetor 2023

BASHKËPUNIMIN ME ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DHE INSTITUCIONE TË HUAJA

Bashkëpunimi ndërkombëtar është realizuar edhe nëpërmjet përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së Drejtorit dhe stafit të Agjencisë në aktivitete brenda dhe jashtë vendit përfshirë pjesëmarrje në vizitat ndërkombëtare dhe rajonale, përfaqësime në konferenca rajonale dhe aktivitete të tjera me qëllim të përfaqësimit të Agjencisë dhe shkëmbimit të përvojave me të mira në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit:

- Një delegacion i Agjencisë i kryesuar nga Drejtori, Yll Buleshkaj, ka marr pjesë ne takimin e trete rajonal të organizuar nga RAI, në Sarajevë, për përmirësimin e politikave publike në mbrojtjen e sinjalizuesve./31 janar 2023
- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit Yll Buleshkaj ka marr pjesë në Forumin Rajonal "Politikat Kundër Korrupsionit si Garanci për Sigurinë Kombëtare, Stabilitetin dhe Sovranitetin" në Sofje të Bullgarisë/22 Mars 2023
- Në kuadër të shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve, delegacioni i Kosovës i kryesuar nga Drejtori i APK-së Yll Buleshkaj, qëndroi për vizitë studimore Irlandë ku është pritur nga udhëheqësit e institucioneve homologe të specializuara në mbrojtjen e sinjalizuesve dhe mekanizmeve për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. /27 Prill 2023
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës po shkëmben përvojat në lidhje me procesin e planeve institucionale të integritetit me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit të Malit të Zi
- Një delegacion i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, i udhëhequr nga Drejtori i Agjencisë. Yll Buleshkaj, të shoqëruar nga përfaqësuesit e Organizatës Jo Qeveritare Lëvizja FOL dhe UNDP në Kosovë, qëndroi në vizitë një-ditore në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit të Malit të Zi/ 7 qershor 2023
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në Evenimentin Rajonal të organizuar nga Sekretariati i Iniciativës Rajonale Kundër Korrupsionit (RAI) Regional Anti-Corruption Initiative - RAI për Monitorimin dhe Vlerësimin e Mekanizmave Legjislativ për Vlerësimin kundër - korrupsion të akteve ligjore./23 qershor 2023
- Në datat 12-13 shtator 2023, me qëllim të shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare për mekanizmat e parandalimit dhe luftimin e korrupsionit, informimi dhe edukimin e publikut, si dhe për mbrojtjen e sinjalizuesve, delegacioni i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) i kryesuar nga drejtori, Yll Buleshkaj, qëndroi për vizitë studimore dy ditore në Austri. Delegacioni është pritur në Zyrën e Koordinatorit të Aktiviteteve Ekonomike dhe Mjedisore të OSBE-së

(OCEEA) dhe në Byronë Federale Kundër Korrupsionit të Austrisë (BAK). Ky aktivitet u zhvillua me organizimin dhe përkrahjen e OSCE./12-13 shtator 2023

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, mori pjesë në konferencën e organizuar nga Instituti Republikan Ndërkombëtar me temën "Mprehja e përgjigjes së demokracisë ndaj kleptokracisë transnacionale", në Romë, Itali, më 18, 19 dhe 20 shtator 2023. Drejtori Buleshkaj ishte pjesë e panelit diskutues ku u diskutua për përpjekjet e BE-së dhe të nivelit kombëtar për të avancuar transparencën mbi pronësinë përfituese, duke përfshirë reformat e nevojshme të politikave, përmirësimin e bazave të të dhënave ekzistuese dhe qasjen, por edhe adresimin e sfidës për të siguruar të drejtat e privatësisë. /18-20 shtator 2023

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit mori pjesë në tryezën rajonale me temën 'Promovimi i Edukimit Kundër Korrupsionit' të organizuar nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC) dhe financuar nga Republika Federale e Gjermanisë (German Cooperation). Tryeza u mbajt në Bečići, Mali i Zi./22 shtator 2023

-Drejtori i Agjencise mori pjesë në Takimin e 22 të Monitorimit dhe në Takimin e 28 të Grupit Drejtues të Rrjetit Kundër Korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore (ACN) të Organizatës për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ekonomik OECD-së, të mbajtur në datat 3, 4 dhe 5 tetor 2023. /3-5 tetor 2023

- Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj, mori pjesë në Punëtorinë Rajonale për Zhvillimin e Mekanizmave Efektiv të Kontrollit të Investimeve në Ballkanin Perëndimor që po mbahet në Pragë, Republika Çeke. Kjo punëtori organizohet nga Programi i Zhvillimit të së Drejtës Tregtare (CLDP) i Departamentit Amerikan të Tregtisë në Koordinim me Departamentin Amerikan të Tregtisë, Departamentin Amerikan i Shtetit, Departamentin Amerikan të Thesarit, Ambasadës së SHBA në Pragë, dhe Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë së Republikës Çeke./ 10 tetor 2023

Përfaqësuesi i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, z. Esad Ejupi, Drejtor Departamenti, mori pjesë në Simpoziumin e nivelit ekzekutiv i cili fokusohet në udhëheqjen strategjike dhe bashkëpunimin ndërkombëtar në lidhje me zbulimin efektiv, hetimin dhe ndjekjen e korrupsionit. Simpoziumi organizohet nga Akademia Ndërkombëtare e Zbatimit të Ligjit e Roswell (Ilea Roswell) në Akademinë Ndërkombëtare të Zbatimit të Ligjit në Budapest ([ILEA Budapest - International Law Enforcement Academy](#)). / 1 Shkurt 2023

BASHKËPUNIMI RAJONAL

- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit e Kosovës merr pjesë në Konferencën Rajonale "Transpozimi i Direktivës së BE-së për sinjalizimin në Ballkanin Perëndimor: Përvoja dhe mësimet e nxjerra nga shtetet anëtare të BE-së të Evropës Juglindore", të organizuar në Tiranë nga Koalicioni i Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve një rrjet rajonal i OJQ-ve, në mesin e përfaqësuesve nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia, Bullgaria, Greqia, Rumania dhe nga Delegacioni i EU në Shqipëri. /13 qershor 2023
- Nje delegacion i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit i kryesuar nga drejtori z. Yll Buleshkaj vizitoi Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI). Delegacioni Kosovar u prit nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Evgjëni Bashari dhe bashkëpunëtorët e saj. /8 nëntor 2023
- Drejtori i Agjencise po merr pjesë në Konferencën Rajonale "Zvogelimi i hendekut: Deklarimi efektiv i asetëve në Evropën Juglindore." e organizuar në Shkup, Maqedonia e Veriut. / 20 dhjetor 2023

AKTIVITETET MEDIATIKE

Si rezultat i përmbushjes së qëllimit për të realizuar mandatin e saj me transparencë dhe llogaridhënie, Agjencia ka rritur maksimalisht numrin e veprimeve konkrete duke bashkëpunuar me të gjithë akterët relevant për parandalimin e korrupsionit në Kosovë dhe në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023 ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve mediale, të vetëdijesimit të publikut të gjerë.

Aktivitetet mediale të Agjencisë gjatë vitit 2023 u fokusuan në komunikimin me media, organizmit të konferencave, intervistat për media dhe bashkëpunimin me mediat në inicimin e trajtimit të rasteve për parandalim të konfliktit të interesit, procedurat e hetimeve administrative dhe dyshime për deklamim jo-të saktë të pasurisë si dhe nëpërmjet publikimit pro-aktiv të informatave në ueb-faqen e APK-së. Në vitin 2023, Agjencia organizoi tri konferenca për media:

- Konferenca për media – Çmimi për Zyrtaret me të suksesshëm për trajtim të rasteve të sinjalizimit
- Fillimi i procesit të monitorimit nga Këshilli i Evropës
- Fushata informuese për mandatin e APK-së – Duke përfshirë 2 video informative që u transmetuan në televizionin publik dhe rrjete sociale
- Në kuadër të informimit dhe llogaridhënies publike dhe përgjigjeve në kërkesat e gazetareve gjatë vitit 2023, u realizuan gjithsej 42 intervista apo prononcime;
- *Nga 54 përgjigje të ofruara për mediat në vitin 2021, dhe 165 përgjigje në vitin 2022, në periudhën raportuese janar-dhjetor 2023, Agjencia ofroi përgjigje për rreth 145 pyetje të pranuar nga mediat*

AKTIVITETET E VETËDIJESIMIT TË PUBLIKUT

Me qëllim të informimit të zyrtarëve publik lidhur me respektimin e obligimeve të përcaktuara për deklarimin e pasurisë, Agjencia ka përgatitur 3 spote televizive: 1) Thirrje për deklarim të pasurisë, 2) Thirrje për raportim të korrupsionit dhe bashkëpunim institucional; 3) Mandati i APK . Këto janë transmetuar në Radio Televizionin Publik të Kosovës (RTK).

Si rezultat i bashkëpunimit me Organizatat Jo-Qeveritare, mbështetur nga Ambasada Amerikane në Prishtinë më 23 dhjetor 2022, Drejtori i Agjencisë pas nënshkrimit të Marrëveshje të Bashkëpunimit mes Agjencisë me Organizatën Jo-Qeveritare AKTIV që ka për qëllim vetëdijesimin e publikut në lidhje me raportimin e korrupsionit ka lansuar një aplikacioni mobil të veçantë për raportim të korrupsionit nga komunitetet jo-shumicë i realizuar e në kuadër të projektit të Byrosë Ndërkombëtare për Lëndë Narkotike dhe Zbatim të Ligjit (INL) “Rritja e transparencës dhe sundimit të ligjit në komunat me shumicë Serbe në Kosovë”.

Shtrirja e aktiviteteve të komunikimit me qëllim të rritjes së besimit të qytetarëve në Agjenci, ka rezultuar gjithashtu me realizimin e katër takimeve me studentë si dhe pjesëmarrjes së Drejtorit të Agjencisë në katër aktivitete të organizuara nga Organizatat Jo-Qeveritare me qëllim të përfshirjes së të rinjve në iniciativat për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

- Drejtori i Agjencisë priti në takim studentët e Klinikës Ligjore të IKD-së dhe i informoi studentët lidhur me procesin e deklarimit të pasurisë së zyrtarëve publik dhe veprimet e Agjencisë -së deri në përfundimit e verifikimit të informatave dhe bërjen publike të regjistrave të deklarimit vjetor të pasurisë.

KËRKESAT PËR QASJE NË INFORMATA PUBLIKE

Gjatë periudhës raportuese, Agjencia pranoi 25 kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat u trajtuan konform Ligjit. Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Nga gjithsej 25 kërkesa, për 23 nga kërkesat u ofrua qasje e plotë në informacion, ndërsa për 2 nga kërkesat, bazuar në dispozitat ligjore të legjislacionit në fuqi u ofrua qasje e pjesshme në informacion.

Trajtimi i kërkesave për Qasje në dokumente publike janar- dhjetor 2023
25 kërkesa të pranuar
23 qasje e plotë në informacion,
2 qasje e pjesshme në informacion

Profili e subjekteve që kërkuan qasje në dokumente publike: 12 kërkesa u pranuan nga mediat, 10 kërkesa u pranuan nga Organizata Jo-Qeveritare, 2 kërkesa nga persona privat, dhe 1 kërkesë u pranua nga të tjerë.

Natyra e kërkesave për qasje ishte si në vijim:

1. Dokumente administrative- 13
2. Dokumente ligjore dhe nën ligjore- 1
3. Statistika- 5
4. Të tjera-6

RAPORT LIDHUR ME TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT TË JASHTËM

Gjatë vitit 2023 janë pranuar dhe evidentuar gjithsejtë 20 raste.

Sa i përket këtyre rasteve, dy raste janë në procedurë të hetimit, ndërsa për 18 raste ka përfunduar procedura e hetimit administrativ dhe epilogu i të njëjtave është si në vijim:

- 1 rast pas trajtimit në kuadër të sinjalizimit të jashtëm është përcjellë si Informatë në Prokurorinë e Shtetit, sa i përket njërit pretendim të informatës;

Ndërsa lidhur me pretendimin tjetër të informatës së pranuar, rasti është mbyllur, sepse është konstatuar se nuk ka prova të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për vërtetimin e shkeljeve ligjore sipas ligjit.

- 1 rast është përcjellë si Informatë në Prokurorinë e Shtetit, sa i përket njërit pretendim të informatës;

Ndërsa, lidhur me pretendimin tjetër të informatës së pranuar, mbyllet rasti, sepse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizimit nuk përbën shkelje sipas ligjit.

- 2 raste është përcjellë si Kërkesë për procedim të mëtutjeshëm te organi kompetent;
- 1 rast është refuzuar, sepse Agjencia vlerëson se informacioni nuk përbën raportim për një kërcënim ose cenim të interesit publik, që është i mbrojtur në kuptim të dispozitës së nenit 5 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në ndërlidhje me dispozitën e nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1 dhe 1.2. të këtij ligji, sa i përket njërit pretendim të informatës.

Ndërsa, lidhur me pretendimin tjetër të informatës së pranuar, për konflikt të interesit, rasti është trajtuar nga Departamenti për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

- 1 rast është refuzuar, sepse i njëjti fillimisht duhej të trajtohej brenda institucionit përmes sinjalizimit të brendshëm.

Agjencia përmes një shkrese i është drejtuar punëdhënësit të institucionit publik të caktuar, përmes së cilës e ka njoftuar për obligimin për të kryer hetimin administrativ të sinjalizimit të brendshëm, bazuar në nenin 16 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në ndërlidhje me nenin 17 paragrafi 4 të këtij ligji.

- 1 rast është refuzuar për tu trajtuar si sinjalizim i jashtëm, sepse pretendimet e informatës mund të trajtohen në Agjenci, nga departamentet përkatëse, sipas ligjeve të veçanta dhe procedurave të veçanta përkatëse për trajtimin e tyre.

Informacioni është përcjellë në kompetencë të Departamentit për Parandalimin Korrupsionit, në kuadër të Agjencisë, për tu trajtuar sipas Ligjit nr.08/L-108 për Deklarimin, prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave.

- 7 raste janë refuzuar, sepse nuk janë konfirmuar të gjitha informatat/të dhënat të cilat parashihen të plotësohen nga ana e raportuesi të informatës, sipas nenit 15, në ndërlidhje me nenin 3 paragrafi 1. pika 1.1 dhe 1.5 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, në bazë të cilave do duhej të trajtoheshin rastet si sinjalizim i jashtëm.
- 3 raste janë mbyllur, sepse rezulton se veprimi ose praktika e dyshuar e sinjalizuar nuk përbën shkelje sipas ligjit.
- 1 rast është refuzuar sepse, pretendimet e ngritura tejkalojnë kompetencat ligjore dhe mundësitë reale për hetim administrativ të tyre nga Agjencia, dhe se është konfirmuar se tashmë rasti i njëjtë është duke u trajtuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Agjencia, ka ofruar përgjigje/njoftime me shkrim në 7 raste, lidhur me informata të pranuar nga zyrtarë të institucioneve të ndryshme, të cilët kanë kërkuar informata rreth sinjalizimit, ose nga zyrtarë/persona anonim të cilët kanë provuar të raportojnë informacione për ndonjë kërcënim ose cenim të interesit publik, mirëpo gjatë vlerësimit dhe trajtimit fillestar të raportimit është konstatuar se nuk i përmbushin kushtet për t'u trajtuar sipas Ligjit Nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Informimi dhe ngritja e kapaciteteve për Zyrtar Përgjegjëse për Sinjalizim

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve dhe njohurive praktike të zyrtarëve përgjegjës për zbatimin e kornizës ligjore vendore për mbrojtjen e sinjalizuesve, Agjencia, me mbështetje të Projektit kundër Krimit Ekonomik (PECK III)- Këshilli i Evropës dhe OSCE- Misioni në Kosovë, ka realizuar pesë punëtori, lidhur me “Sinjalizimin, hetimin administrativ, rolin e zyrtarëve përgjegjës dhe rolin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit”, tri prej të cilave janë mbajtur gjatë muajit tetor, ndërsa dy gjatë muajit nëntor. Në këto punëtori kanë marrë pjesë gjithsejtë 119 zyrtarë përgjegjës për sinjalizim, përfshirë zyrtarë nga institucionet qendrore, institucionet lokale, agjencitë e pavarura, ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike lokale.

Po ashtu, në vazhdimësi gjatë vitit 2023 Agjencia ka zhvilluar takime dhe kontakte me zyrtarët përgjegjës për sinjalizim në kuadër të institucioneve publike, me qëllim të bashkëpunimit dhe koordinimit të praktikave dhe përvojave, në funksion të zbatimit të Ligjit Nr. 06/L-085 Për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Raport gjashtë mujor lidhur me sinjalizimin, 01 janar - 30 qershor 2022

Me qëllim të përcjelljes së dinamikës së zbatimit të Ligjit nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, përmes emailit të datës 01.06.2023, kemi kërkuar nga zyrtarët përgjegjës për sinjalizim, të Institucioneve Publike, që të përgatisin Raport gjashtë mujor, (01 janar - 30 qershor 2023) lidhur me sinjalizimin, dhe të njëjtin ta përcjellin në Agjenci.

Këtë raport e kanë përcjell në Agjenci 149 institucione publike, respektivisht 169 zyrtarë përgjegjës, (disa Institucione Publike që kanë shtrirje në territorin e Republikës së Kosovës, kanë caktuar zyrtarë përgjegjës edhe në njësitë e tyre regionale), derisa 33 institucione publike, respektivisht 39 zyrtarë përgjegjës, nuk e kanë përcjellë këtë raport.

Sipas raporteve të pranuar, rezulton se në kuadër të sinjalizimit të brendshëm janë trajtuar 36 raste. Sa i përket gjinisë së raportuesve të informatave, 10 prej tyre janë sinjalizues të gjinisë femërore, ndërsa 21 të gjinisë mashkullore.

RAPORTET VJETORE NGA INSTITUCIONET PUBLIKE, SUBJEKTET PRIVATE, SI DHE RREGULLATORËT LIDHUR ME SINJALIZIMIN, 01 JANAR -31 DHJETOR 2023

Agjencia bazuar në nenin 29 paragrafi 2 të Ligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, pranon nga institucionet publike, subjektet private, si dhe rregullatorët raportet vjetore lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor.

Lidhur me këtë, Agjencia zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të institucioneve publike iu ka rikujtuar obligimin ligjor në kuptim të nenit 29 të Ligjit nr.06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, si dhe nenit 17 të

Rregullores Nr.03/2021, për Përcaktimin e Procedurës për Pranimin dhe Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, që si Institucion Publik të përgatisin Raportin Vjetor lidhur me sinjalizimin për vitin paraprak deri më 31 dhjetor dhe të njëjtin ta paraqesin në Agjenci më së voni deri me 31 janar të vitit vijues.

Andaj në kuptim të nenit 29 paragrafi 3 i Ligjit nr.06/L-085 për mbrojtjen e sinjalizuesve, Agjencia publikon Raport Vjetor të përgjithshëm lidhur me sinjalizimin për vitin 2023, sipas të cilit, këtë raport e kanë përcjell në Agjenci 156 institucione publike, respektivisht 183 zyrtarë përgjegjës (disa Institucione Publike që kanë shtrirje në territorin e Republikës së Kosovës, kanë caktuar zyrtarë përgjegjës edhe në njësitë e tyre regjionale), dhe 2 subjekte private, ndërsa raportin nuk e kanë paraqitur 23 institucione publike.

Sipas raporteve të pranuara, rezulton se në kuadër të sinjalizimit të brendshëm janë trajtuar 84 raste. Sa i përket gjinisë së raportuesve të informatave, 22 prej tyre janë sinjalizues të gjinisë femërore, 51 të gjinisë mashkullore dhe 11 janë raportues anonim.

PUBLIKIMI I EMRIT TË ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PRANIMIN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË SINJALIZIMIT

Agjencia përmes një shkrese elektronike i është drejtuar zyrtarëve përgjegjës për sinjalizim të Institucioneve Publike, prej të cilëve, ka kërkuar që në kuptim të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e sinjalizuesve në Kosovë, në koordinim me udhëheqësin e institucionit, të bëjnë publik identitetin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në faqen e internetit të institucionit të tyre, ndërsa institucionet që nuk kanë faqe zyrtare të internetit, deri në krijimin e një faqe të tillë, emrin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim ta bëjnë publik në hapësirat e institucionit të tyre, respektivisht në tabelën e shpalljeve.

Është kërkuar gjithashtu që Agjencia të njoftohet lidhur me publikim e emrit të zyrtarit përgjegjës në faqen e internetit, dhe të njoftohet me kohë për çdo ndryshim të emrit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim.

Institucionet Publike, të cilat kanë informuar Agjencinë lidhur me publikimin e identitetit të zyrtarit përgjegjës për sinjalizim në faqen e internetit të institucionit dhe hapësirat e institucionit të tyre ose në forma tjera, respektivisht në tabelën e shpalljeve, janë gjithsejtë 144, institucione publike.

Publikimi i emrit të zyrtarit përgjegjës për pranimin dhe trajtimin e rasteve të sinjalizimit, nga ana e institucioneve publike, është publikuar si më poshtë;

- 121 në ueb faqen e institucionit;
- 4 kanë publikuar vendimin për caktimin e zyrtarit përgjegjës për sinjalizim, në ueb faqe të institucionit;
- 16 në tabelën e shpalljeve;
- 3 përmes emailit e kanë njoftuar stafin.

MËSIMET E NXJERRA DHE PRIORITETET NË TË ARDHMEN

Menaxhmenti i Agjencisë edhe gjatë vitit 2023 është fokusuar në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies institucionale duke garantuar paanshmëri dhe trajtim të barabartë gjatë ushtrimit të fushë veprimtarisë së vet. Kjo ka ndikuar në vazhdimin e rritjes së besimit në Agjenci, përmes rritjes së numrit të raportimeve për deklarim të pasaktë të pasurisë, raportimeve për konflikt të mundshëm të interesit dhe veprime të mundshme korruptive në prokurimin publik, nga qytetarë, grupe të ndryshme të interesit, institucione, dhe zyrtarët më të lartë të shtetit.

Sensibilizimi i zyrtarëve publik në fushën e parandalimit të konflikti të interesit ka qenë fokus gjatë vitit 2023 ku janë realizuar programe të specializuara të trajnimeve për autoritetet përgjegjëse të konfliktit të interesit. Forcimi i ndërgjegjësimit dhe rritjes së integritetit të zyrtarëve publik ka ndikuar që numri i rasteve të paraqitura për konflikt të mundshëm të interesit të zvogëlohet në vitin 2023. Mbetet qëllim i Agjencisë ngritja e nivelit të standardit të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së zyrtarëve publik që vet ata të trajtojnë konfliktin e interesit gjatë procesit të vendimmarrjes dhe ushtrimit të funksionit zyrtar dhe më iniciativat vetanake t'i shmangin situatat e mundshme të konflikt të interesit.

Profilizimi i Agjencisë konform përgjegjësive dhe kompetencave të reja të përcaktuara me Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë i ka hapur rrugë organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës duke mundësuar shpërndarjen e resurseve njerëzore në realizimin e plotë të mandatit të saj ligjor. Aprovimi i pozitive të reja shtesë për Agjencinë do të mundësoj që gjatë rekrutimit të shtoj dhe forcoj ekspertizën profesionale të saj.

Aplikimi i sistemit të deklarimit elektronik ka thjeshtëzuar procesin e deklarimit të pasurisë dhe dorëzimit, duke rritur transparencën dhe saktësinë në monitorimin dhe verifikim të pasurisë së deklaruar. Instalimi i sistemit të deklarimit të pasurisë On- line si prioritet i vitit 2023 ka sjellë lehtësira dhe përparësi në publikimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik duke ngritur në një nivel më të lartë saktësinë e të dhënave dhe informatave të sakta të deklarimit të pasurisë, duke evituar lëshimet e mundshme që janë bërë në të kaluarën, ndërsa publikimi i regjistrave të deklarimit të pasurisë është bërë në një afat të shpejt kohor që dukshëm i ka kontribuar rritjes së transparencës në deklarimin e pasurisë së zyrtarëve publik.

Agjencia intensivisht ka përmirësuar punën e saj në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe fushatat informuese me qëllim informimin e publikut të gjerë dhe atij profesional në lidhje me fushëveprimin e APK-së.

Në mungesë të ofrimit të shërbimeve nga kompania kontraktuese për të ju përgjigjur kërkesave të Agjencisë, si dhe në mungesë të kapaciteteve profesionale të teknologjisë informatave brenda Agjencisë, për publikimin e informatave dhe dokumenteve në ueb-faqen e Agjencisë, edhe gjatë vitit 2023, ka evidentuar mangësi në publikimin e informatave, mirëpo të cilat kanë arritur që të adresohen me kohë.

Shtimi i kapaciteteve profesionale për të ngritur procesin e sinjalizimit në nivelin e dëshirueshëm në publik që do ti kontribuonte krijimit të një klimë në të cilën sinjalizuesit do të ndihen të mbrojtur dhe të motivuar për të raportuar dyshimet e mundshme për afëra korruptive, është adresuar përmes procesit të organizimit dhe sistematizimit të vendeve të punës në Agjenci. Është e rëndësishme së veçantë që të kuptohet se sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve është një mekanizëm parandalues i korrupsionit që kontribuon në forcimin e përgjithshëm të integritetit në institucionet e sektorit publik dhe atij privat.


Agjencia synon që përmes forcimit të ekspertizës profesionale dhe shtimit të kapaciteteve të saj, përmes vlerësimit të rrezikut të korrupsionit në sektorë të ndjeshëm, evitimit të zbrazëtirave në legjislacion që mundësojnë korrupsionin dhe monitorimit të planeve të integritetit të kontribuoj fuqishëm në parandalimin e korrupsionit në Kosovë.

Kërkesat dhe nevojat e identifikuara nga Agjencia gjatë realizimit të planit vjetor të performancës së Agjencisë për vitin 2023, janë mbështetur e përkrahur nga partnerët e ndryshëm përmes projekteve. Forcimi i bashkëpunimit me ata që mbështesin punën e Agjencisë, synohet të vazhdohet edhe më tutje.


Kujdes i shtuar edhe në vijim do të kushtohet digjitalizimit të proceseve të ndryshme që realizohen nga Agjencia gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, përmes zhvillimit të platformave të ndryshme për komunikim dhe qasje më të lehtë. Trajnimi dhe profesionalizimi i stafit të Agjencisë qoftë atij ekzistues apo atij që do të rekrutohet në të ardhmen, por edhe e të gjithë zyrtarëve kontaktues të Agjencisë nëpër institucione tjera që kanë përgjegjësi të caktuara ligjore në raport me Agjencinë dhe jo vetëm, është i një rëndësie të veçantë.

Theks i veçantë nga të gjitha institucionet përgjegjëse duhet të filloj që të kushtohet forcimit të autoriteteve përgjegjëse për parandalimin e konfliktit të interesit dhe zyrtarëve përgjegjës për mbrojtjen e sinjalizuesve përmes krijimit të kushteve adekuate të punës për ta, por edhe zyrtarëve tjerë kontaktues të Agjencisë nëpër institucione tjera që kanë përgjegjësi të caktuara ligjore në raport me Agjencinë.

SHTOJCA NR. 1. ORGANOGRAMI I AGJENCISË I VJETËR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)



SHTOJCA NR. 2. ORGANOGRAMI I AGJENCISË I RI PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT (APK)



SHTOJCA NR.3. LISTA E PJESËMARRJES NË TRAJNIME, FORUME, SEMINARE GJATË VITIT 2022

Nr.	Lloji i Trajnimit	Organizon	Vendi	Data	Numri i Zyrtarëve Pjesëmarrësve
1.	Hetimet e Korrupsionit në Sektorin Publik	Ambasada e SHBA	Budapest	23.01-04.02.2023	1
2.	Sigurimi i mbrojtjes së fuqishme për punonjësit që raportojnë shkelje	RAI	Sarajevë	31.01-02.02.2023	2
3.	Rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës	APK	Tiranë	10-13.02.2023	10
4.	Menaxhimi i Kontratë përmes e-Prokurimit	IKAP	Prishtinë	13-14.02.2023	6
5.	Procesi i Klasifikimit të Vendeve të Punës për Zyrtarët Publik	MPB	Prishtinë	01.03.2023	1
6.	Përpunimi dhe Mbrojtja e të Dhënave Personale	IKAP	Prishtinë	14-15.03.2023	1
7.	Forumi Rajonal Politikat Kundër Korrupsionit si Garanci për Sigurinë Kombëtare, Stabilitetin dhe Sovranitetin	SELDI dhe CSD	Bullgari	20-22.03.2023	1
8.	Lufta kundër mashtrimit me fonde të Be-së: bashkëpunimi midis OLAF dhe autoriteteve në Ballkanin Perëndimor	Zyra Evropiane kundër Mashtrimit(OLaF)	Beograd	21-22.03.2023	1
9.	Menaxhimi i Kontratave	IKAP	Prishtinë	23-24.03.2023	6
10.	Trajnim për evazionin TATIMOR dhe ekonominë joformale	OSBE	Prishtinë	28-29.03.2023	1
11.	Ngjarje Rajonale për Vërtetimin e Legjislacionit ndaj Korrupsionit për Sektorët e Arsimit të Lartë dhe ndërmarrjeve Publike	RAI	Beograd	05.04.2023	2
12.	Të drejtat dhe detyrat e zyrtarëve publik dhe Kodi i Mirësjelljes	IKAP	Prishtinë	07.04.2023	1
13.	Hartimi i dokumenteve që ndërlidhen me deklarin e dhuratave dhe shqyrtimit të pozitave të reja deklaruese sipas ligjit të ri	APK SAEK III UNDP	Istog	06-07.04.2023	9

14.	Ekzekutimi i buxhetit dhe procedurat në vitin 2023	IKAP	Prishtinë	19-20.04.2023	2
15.	Hetimet dhe Sanksionet në mbikëqyrjen zyrtare të financave politike	IFES	Çeki	18-21.04.2023	1
	Funksionimi i mekanizmit të sinjalizimit dhe procedurat e tij	PECK III	Irlandë	25-28.04.2023	2
16.	Metodën e pavarur të hetimit të integruar dhe metodën e re të operimit për pastrimin e parave	OSBE	Prishtinë	08-10.05.2023	4
17.	Programi i investimeve publike(PIP) dhe Sistemi i zhvillimit dhe menaxhimit të buxhetit(BDMS),	IKAP	Prishtinë	05-09.06.2023	3
18.	Transpozimi i Direktivës së BE-së për sinjalizimin e Ballkanit Perëndimor: Përvojat dhe mësimet e nxjerra nga shtetet anëtare të BE në Evropën Juglindore	Koalicioni i Evropës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve	Tiranë	12-13.06.2023	2
19.	Kontabilitet dhe aftësi analitike në hetimin e integruar të krimeve financiare	OSBE	Prishtinë	14-16.06.2023	2
20.	Projekti i rekrutimit për pozita të larta	Ambasada Britanik	Prishtinë	17.06.2023	1
21.	Trajnim i avancuar i prokurimit publik dhe integritetit institucional	OSBE	Prishtinë	19-20.06.2023	5
22.	Tryezë Rajonale për monitorimin dhe vlerësimin e Mekanizmave të shqyrtimit kundër korrupsion të legjislacionit	RAI	Bosnje dhe Hercegovinë	22-24.06.2023	1
23.	Prezantimi i Planit Kontabël të Përditësuar dhe Udhëzuesit të Planit Kontabël	USAID	Prishtinë	30.06.2023	4
24.	Takimi i trembëdhjetë për zbatimin e Ligjit të rrjetit kundër korrupsionit për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore	OECD	Kazakistan	04-09.09.2023	1
25.	Kurs i gjuhës serbe	Zyra e Kryeministrit	Prishtinë	04.09.2023 vazhdon	13
26.	Takim me zyrën e koordinatorit të aktiviteteve Ekonomike dhe mjedisore të OSBE dhe Byrosë federale kundër korrupsionit BAK	OSBE	Austri	11-14.09.2023	3

27.	Rritja e bashkëpunimit midis Institucioneve të Auditimit dhe organet kundër korrupsion	UNODC	Prishtinë	12-14.09.2023	3
28.	Bashkimi dhe Rimëkëmbja në Evropë mbi Transparencën e Pronësisë përfituese	IRI	Itali	18-21.09.2023	1
29.	Vizitë studimore	APK	Mal i Zi	20-22.09.2023	5
30.	Promovimi dhe Edukimi i të Rinjve në fushën kundër korrupsionit	UNOCD	Mal i zi	21-23.09.2023	2
31.	Plani kontabël dhe kontabiliteti në SIMFK	IKAP	Prishtinë	26-27.09.2023	2
32.	Takimi i 22 të Monitorimit të planit të veprimit kundër korrupsionit (IAP) të Stambollit, dhe Takimin e 28 të Grupit drejtues të rrjetit kundër korrupsionit (ACN)	OECD	Francë	02-06.10.2023	2
33.	Hartimi i Planit të Integritetit për APK-në	OSCE APK	Prizren	04-06.10.2023	16
34.	Finalizimi i Planit të Performancës për APK-në për vitin 2024	APK	Tiranë	07-10.11.2023	10
35.	Rregullorja për Organizimin e brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës	OSBE APK	Pejë	15-17.11.2023	13
36.	Ndarja e Përvojave në reformimin e Policisë	QKSS	Tiranë	23-24.11.2023	2
37.	Gjendja aktuale lidhur me korrupsionin në prokurimin publik në vendet e Ballkanit Perëndimor	Ballkan Tender Watch	Maqedoni e Veriut	06-08.12.2023	3
38.	Hartimi i draftit fillestar të Rregullores për Hetime administrative	APK	Tiranë	08-10.12.2023	8
39.	Plani i Integritetit 2024-2025 MPB	MPB	Prizren	07-09.12.2023	2
40.	Regjistrimi i Pasurive Kapitale në SIMFK	MF	Prishtinë	14.12.2023	2
41.	Ligji i ri për Zyrtarët Publik dhe përdorimi i SIMBNJ-së	MPB	Prishtinë	19.12.2023	1

Lista e subjekteve deklaruese që nuk kanë respektuar afatin e deklarimit të pasurisë DRV:

Nr.	Emri	Mbiemri	Pozita	Institucioni
1.	Hamid	Zukaj	Këshilltar i Kuvendit Komunal	Komuna e Deçanit
2.	Hekuran	Hoxha	Këshilltar i Kuvendit Komunal	Komuna e Gjakovës
3.	Florin	Dreshaj	Këshilltar i Kuvendit Komunal	Komuna e Istogut
4.	Kushtrim	Kozmaqi	Zëvendësues Udhëheqës i Divizionit	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
5.	Nijazi	Halili	Anëtar i Këshillit Shkencor	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
6.	Daut	Demaku	Këshilltar i Jashtëm Politik	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
7.	Erleta	Qestaj	Këshilltar i Kuvendit Komunal	Komuna e Junikut
8.	Arta	Shehu	Anëtar i Këshillit Drejtues	Universiteti "Hasan Prishtina" Prishtinës
9.	Fatlum	Sadiku	Këshilltar Politik	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
10.	Abdyl	Gashi	Këshilltar i Kuvendit Komunal	Komuna e Novobërdës
11.	Vlora	Dumoshi	Deputete	Kuvendi i Republikës së Kosovës

Lista e subjekteve deklaruese që nuk kanë respektuar afatin e deklarimit të pasurisë DMD:

Nr.	Emri	Mbiemri	Pozita	Institucioni
1.	Ruzhdi	Zeneli	Shef	Policia e Kosovës
2.	Ramadan	Miftari	Zyrtar i Teknikës Kriminalistike	Policia e Kosovës
3.	Fatmir	Kamerolli	Hetues	Policia e Kosovës
4.	Egzon	Abazi	Hetues	Policia e Kosovës
5.	Sabri	Gashi	Mbikëqyrës	Policia e Kosovës
6.	Faik	Sadiku	Hetues	Policia e Kosovës
7.	Nenad	Stankovic	Hetues	Policia e Kosovës
8.	Semir	Isufi	Zyrtar i Inteligjencës	Policia e Kosovës
9.	Haxhë	Lekaj	Zyrtar në Dhomën e Dëshmive	Policia e Kosovës
10.	Vera	Nikolic	Zyrtar i Prokurimit	Policia e Kosovës
11.	Agim	Zymeri	Mbikëqyrës	Policia e Kosovës
12.	Kadri	Kadriu	Shef	Policia e Kosovës

13.	Besnik	Nika	Hetues	Policia e Kosovës
14.	Ihsan	Fetahaj	Mbikëqyrës	Policia e Kosovës
15.	Goran	Milisavljevic	Inspektor i Kontrolleve Teknike	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
16.	Radisa	Tomovic	Inspektor i Transportit	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
17.	Vladimir	Tomovic	Inspektor i Infrastrukturës rrugore	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
18.	Dejan	Radovic	Inspektor i Auto Shkollave	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
19.	Muhamet	Kastrati	Inspektor Veterinar	Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës
20.	Strahinja	Stevic	Inspektor Sanitar	Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës
21.	Ivana	Zivic	Inspektor Sanitar	Agjensioni i Ushqimit dhe Veterinës
22.	Rrahman	Jashari	Anëtar	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
23.	Petrit	Balia	Anëtarë i Këshillit për Mbikëqyrje dhe Licencim të Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme	Ministria e Financave
24.	Osman	Halitaj	Inspektor Tatimor	Administrata Tatimore e Kosovës
25.	Milenko	Milintijevic	Oficer i Lartë Doganor	Dogana e Kosovës
26.	Agmet	Zejneli	Oficer Doganor	Dogana e Kosovës
27.	Dejan	Stanojevic	Inspektor i Punës	Inspektorati i Punës